



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:133561

Datë: 25.09.2023

Numri i dokumentit: 04716959

PKR.nr.37/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- Departamenti për Krime të Rënda, me Kryetarin e trupit gjykues, Shaqë Curri dhe anëtarët e trupit gjykues, Sami Sharaxhiu dhe Violeta Husaj Rugova, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku, në çështjen penale ndaj të pandehurit, L.B., për veprën penale falsifikim i dokumentit zyrtar, nga neni 427 par.1, të KPRK-së dhe të pandehurit I. H., për shkak të veprës penale të kryer në vazhdimësi, keqpërdorim i pozitës zyrtare, apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.2, lidhur me par.1, lidhur me nenin 81 par.1, pika 1.3, të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.164/20, të dt. 21.02.2022, gjykata mbajti seancën publike të shqyrtimit gjyqësor, me dt.14.04.2023, 18.05.2023, 30.05.2023, 22.06.2023 dhe 26.07.2023, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Valbona Disha-Haxhosaj, i pandehuri L.B. dhe mbrojtësja e tij av. A.K., sipas autorizimit, i pandehuri I.H. dhe mbrojtësi i tij, av. N. D., sipas autorizimit, dhe përf. i aut. të dëmtuarës, B. Z., me datë 31.07.2023, bie dhe shpall publikisht, ndërsa me dt.25.09.2023, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit

L.B., i biri i Bajramit dhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në I, me vendbanim në I., rr “.....”, nr., identifikuar në bazë të lnj.nr. personal, ka të kryer fakultetin juridik, me profesion-jurist i diplomuar, udhëheqës i sektorit për Administratë në kuadër të drejtorisë për Administratë, në Komunën e I., i gjendjes se mesme ekonomike, posedon nr. tel., shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, mbrohet në liri.

I. H., i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në fsh., K. I., ku edhe banon, identifikuar në bazë të lnj.nr. personal, ka të kryer fakultetin juridik, me profesion-jurist, pensionist, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet në liri.

JANË FAJTORË

Për shkak se:

I. I pandehuri L.B.

Me dt. 08.10.2020, në I., duke vepruar si person zyrtar, në dokumentin Zyrtar – Autorizim, shënon të dhëna të rreme dhe me vule zyrtare e vërteton atë, në atë mënyre që, i pandehuri L.B., me te kuptuar se për cilat raste janë duke u hetuar nga organet e hetuesisë, i pandehuri i lartcekur kërkon nga zyrtari ligjorë këtu dëshmitari F.B. ta përpiloj Autorizimin “Zyrtarisht /2018 dt. 18.04.2018, dhe të njëjtën ta dërgoj te Kryetari për nënshkrim, (duke urdhëruar zyrtarin e lartcekur që të hartojë një dokument i cili kinse ka ekzistuar qysh ne vitin 2018) e krejt këtë e bënë me qëllim për të iu shmangur përgjegjësisë penale.

-me çka ka kryer veprën penale “Falsifikim i dokumentit zyrtar” nga neni 427 par. 1 te KPRK-së.

II. I pandehuri I.H.

I. Me dt. 24.10.2017 ne I., si person zyrtar – Udhëheqës i Sektorit pranë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi ne Komunën e I., duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i ka tejkalluar kompetencat e tij, e me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për operatorin ekonomik “.....”, me pronar G. R., ka marr aktvendim me numër të lëndës /protokollit 996/2017, Zona Katastrale C., me te cilën ka aprovuar kërkesën zyrtare që ka të bëjë me parcelizim të pronës dhe regjistrim ne RDPP-en, sipas regjistrimit të terrenit 3/2017 për njësitë kadastrale numër 28/92, 28/93, 28/94 dhe 28/95 ZK C.e (duke e bërë ndërrimin e destinimit të përhershëm të pyllit ose tokës pyjore kompetence të cilën nuk e ka, madje as Agjensioni Pyjori i Kosovës por kompetente është Ministria e Bujqësisë së R. Kosovës, e cila në rastet e veçanta e lejon ne bashkëpunim me APK-në), me te cilin vendim ka bërë ndërrimin e përhershëm të destinimit të tokës bujqësore nga Mal i klasit 3 në tokë jo pjellore, e krejt kjo me qëllim të krijimit të mundësisë së OE „.....” për t’u shmangur nga obligimi për tu pajis me pëlqim për ndërrimin e destinimit të përkohshëm të pyllit ose tokës pyjore ne tokë tjetër nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, si Institucion i vetëm në RKS kompetent sipas Ligjit për tokën Bujqësore 02/L-26, Ligjit për pyje të Kosovës nr.2003/3, Udhëzimit Administrativë numër 10/2010 për Plotësim dhe Ndryshimin e Udhëzimit 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

II. Me dt. 23.03.2018 ne Istog, si person zyrtar – Udhëheqës i Sektorit pranë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi ne Komunën e I., duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i ka tejkalluar kompetencat e tij, e me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për operatorin ekonomik “....”, me pronar G. R., ka marr aktvendim me numër të lëndës /protokollit 13665/2018, Zona Katastrale C., me te cilën ka aprovuar kërkesën zyrtare që ka të bëjë me parcelizim e pronës dhe regjistrim ne RDPP-en, sipas regjistrimit ne terren 7/2018 që ka të bëjë me parcelim prone për njësinë kadastrale 28/96, 28/97 dhe 28/98 ZK C. (duke e bërë ndërrimin e destinimit të përhershëm të pyllit ose tokës pyjore kompetence të cilën nuk e ka madje as Agjensioni Pyjori i Kosovës por kompetente është Ministria e Bujqësisë së R. Kosovës, e cila në rastet e veçanta e

lejon ne bashkëpunim me APK-në), me te cilin vendim ka bërë ndërrimin e përhershëm të destinimit të tokës bujqësore nga Mal i klasit i 3 në tokë jo pjellore, e krejt kjo me qëllim të krijimit të mundësisë së OE „.....” për t’u shmangur nga obligimi për tu pajisur me pëlqim për ndërrimin e destinimit të përkohshëm të pyllit ose tokës pyjore ne tokë tjetër nga Agjencinë Pyjor i Kosovës, si Institucion i vetëm në RKS kompetent sipas Ligjit për tokën Bujqësore 02/L-26, Ligjit për pyje të Kosovës nr.2003/3, Udhëzimit Administrativë numër 10/2010 për Plotësim dhe Ndryshimin e Udhëzimit 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

III. Me dt.05.10.2017 ne I., si person zyrtar – Udhëheqës i Sektorit pranë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi ne Komunën e I., duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtarë, i ka tejkalluar kompetencat e tij, e me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për operatorin ekonomik “.....SHPK”, me pronar F. D., ka marr aktvendim me numër të lëndës /protokollit 867/2017, Zona Katastrale V., me te cilën ka aprovuar kërkesën zyrtarë që ka të bëjë me parcelim pronës dhe regjistrim ne RDPP-en, sipas regjistrit të terrenit, 11/2017, për njësitë katastrale numër 74/5,74/6,74/7,74/8, 256/1,256/2 dhe 256/3 ZK –V., (duke e bërë ndërrimin e destinimit të përhershëm të pyllit ose tokës pyjore kompetence të cilën nuk e ka madje as Agjensioni Pyjori i Kosovës por kompetente është Ministria e Bujqësisë së R. Kosovës, e cila në rastet e veçanta e lejon ne bashkëpunim me APK-në), me te cilin vendim ka bërë ndërrimin e përhershëm të destinimit të tokës bujqësore nga Mal i klasit i 3 në tokë jo pjellore, e krejt kjo me qëllim të krijimit të mundësisë së OE “.....” për t’u shmangur nga obligimi për tu pajisur me pëlqim për ndërrimin e destinimit të përkohshëm të pyllit ose tokës pyjore ne tokë tjetër nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, si Institucion i vetëm në RKS kompetent sipas Ligjit për tokën Bujqësore 02/L-26, Ligjit për pyje të Kosovës nr.2003/3, Udhëzimit Administrativë numër 10/2010 për Plotësim dhe Ndryshimin e Udhëzimit 41/2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

-me çka në vazhdimësi ka kryer vepër penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 par. 2 lidhur me par.1, lidhur me nenin 81 par.1 pika 1.3 te KPRK-së.

Andaj, gjykata konform nenit 7, 38, 40, 42, 59, 62, 69, 70, nenit 427, par.1, nenit 422 par. 2 lidhur me par.1, lidhur me nenin 81, par.1 pika 1.3, te KPRK-së dhe nenit 364 të KPP-se, të pandehurve iu shqipton.

Të pandehurit L.B.

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në arrest shtëpiak, nga dt. 09.10.2020 e deri me dt. 20.10.2020, e të cilin dënim do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri, obligohet që të paguaj, shumën prej 100 (njëqind) euro, ne emër të shpenzimeve të procedurës penale, si dhe shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, për paushallin gjyqësorë, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri, obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 59 dhe 62, të KPP-së, të pandehurit L.B., i shqiptohet dënimi plotësues: ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike, ose në shërbimin publik, në kohëzgjatje prej 2 viteve, pas mbajtjes së dënimit me burg.

Të pandehurit I.H.

Dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 (dy) viteve, e të cilin dënim do ta vuajë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I pandehuri, obligohet që të paguaj, shumën prej 100 (njëqind) euro, ne emër të shpenzimeve të procedurës penale, si dhe shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, për paushallin gjyqësorë, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

I pandehuri obligohet që të paguajë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Pala e dëmtuar, Agjencioni Pyjor i Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzën PP/I.nr.164/20, të dt. 21.02.2022, ndaj të pandehurit H. R., për shkak të veprës penale konflikt interesi, nga neni 424 par. 2, lidhur me par.1, të KPRK-së, të pandehurit L.B., për veprën penale falsifikim i dokumentit zyrtar, nga neni 427 par.1, të KPRK-së dhe të pandehurit I. H., për shkak të veprës penale të kryer në vazhdimësi, keqpërdorim i pozitës zyrtare, apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.2, lidhur me par.1, lidhur me nenin 77 par.1, pika 1.3, të KPRK-së.

Gjykata me dt. 22.09.2022 ka caktuar seancën fillestarë në këtë çështje penale, ne seancë nuk ka qenë prezent i pandehuri H. R., ndërsa Polica e Kosovës –Stacioni Policor në I. me raportin e dt.28.03.2022, ka njoftuar gjykatën, se pas verifikimit sipas urdhëresës së gjykatës nga Qendra për Regjistrim Civil në I. kanë siguruar si dëshmi zyrtare certifikatën e vdekjes se te pandehurit. Raportit policor i kanë bashkangjitur edhe Certifikatën e vdekjes së te pandehurit me numër te referencës 6/2022RV/6001/Sp te dt. 28.03.2022. Në seancën fillestare të dt. 22.09.2022, gjykata ka marrë aktvendim, që ndaj të pandehurit H. R., të hudhët aktakuza e larë cekur dhe të pushoi procedurën penale ndaj tij, meqenëse në shkresat e lëndës ka prova se i njëjti ka vdekur, ndërsa ndaj të pandehurve L.B. dhe I. H., ka vazhduar procedurën e rregullt penale.

Gjykata Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, me dt. dt.14.04.2023, 18.05.2023, 30.05.2023, 22.06.2023 dhe 26.07.2023, ka mbajtur seancat publike të shqyrtimit gjyqësor, ku prezent ishin, Prokurori të Shtetit, Valbona Disha-Haxhosaj, i pandehuri L.B. dhe mbrojtësja e tij av. A.K., sipas autorizimit, i pandehuri I.H. dhe mbrojtësi i tij, av. N. D., sipas autorizimit, dhe përf. i aut. të dëmtuarës, B. Z..

Meqenëse të pandehurit L.B. dhe I. H., nuk e pranuan fajësinë, shqyrtimi gjyqësor vazhdoi me procedurën e provave, fillimisht me fjalët hyrëse të palëve, pastaj me dëgjimin e dëshmitareve, ku në këtë rast janë dëgjuar, përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar Agjencionit Pyjor të Kosovës, në cilësi të dëshmitarit, B. Z., dëshmitaret H. B., H. K., Z. S., I. H. dhe F. B., është lexuar deklarata e dëshmitarit Q. B. e dhënë në Prokurori me dt. 20.01.2021, pasi qe i njëjti për arsye shëndetësore nuk ka mundur te jetë prezent ne seance. Janë administruar provat materiale si; Autorizimi i dt. 18.04.2018, Kontrata për dhënie ne shfrytëzim afatshkurtër të pronës se paluajtshme Komunës përmes ankandit publik me nr. 408/2018 e datës 16.07.2018; Kontrata për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës përmes ankandit publik me nr. 404/2018 e datës 16.07.2018; Autorizim shabllon i dërguar nga L.B. tek zyrtari ligjor F. B. përmes emalit. Emali i pranuar nga F.B. prej ish nënkryetarit L.B.; Kërkesa për rishqyrtim nga MAPL për Komunën e I. datë 15.06.2017 nr 020/737; Aktvendimi i Agjencionit Pyjor të Kosovës Ref KE-542/17; Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtine me nr A nr.1722/2017 me çka i referohet kërkesë padia e paditësit “..... SHPK” që të anulohet vendimi i Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe zhvillimit Rural/Agjencia Pyjore e Kosovës me nr. KE54217, Urdhëresa për sekuestrim të përkohshëm nga PTH- Pejë; Përgjigja nga AKK- agjencia kundër korrupsion i datës 16.09.2020; Deklarata e dëshmitarit B. Z. e dhënë në Polici me datë. 10.03.2020; Vendimi i Ministri i Pushtetit Lokal i datës.15.06.2017; Vendimi i Kuvendit Komunal I. 01-039-4 dt.12.05.2017 (vendimi i nxjerr sipas propozimit paraprak të Kryetarit të Komunës); Vendimi i Komisionit vlerësues (Komisioni Vlerësues për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale), me te cilin janë shpallur fitues kompanitë; Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale, nxjerr nga Kryesuesi Q.B. dt. 05.04.2018; Vendimi i MAPL me rekomandim dt. 21.05.2018; Historiati nga Drejtoria për Kadaster dhe Gjeodezi- I.; Ankandi publik i shpallur nga KK. I. dt. 22.05.2018; Lista e pjesëmarrësve/anëtarëve të komisionit për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme Komunale; Shpallja e kompanive fituese pas ankandit publik nga KK-I.; Raporti i ekzaminimit nga AKF-ja, i shtëpizës së kompjuterit të markës ACR ETXTENSA, i dt. 19.07.2021, Përgjigja përfundimtare nga AKK, ne nr. ref. 02-1742/20 dt. 20.01.2022. Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i dt. 10.10.2020, Raporti informues sipas autorizimit PPN/I nr. 17/20 i dt. 10.07.2020, Kërkesa për vlerësim profesional e dt.11.08.2020, Shpallja e Ankandit publik i dt. 29.03.2018, Vendimi i Kuvendit të Komunës së Istogut e dt. 15.06.2017, Vendimi me nr. 65/2017 e dt. 05.05.2017, Propozimi me nr. 160/2017 i dt. 14.04.2017, Kërkesa për rishqyrtim –Vendimi i Kuvendit të Komunës së I. e dt. 15.06.2017, Vendimi me nr. 68/2017 i dt. 05.05.2017, Shkresa me nr. 62/2018 e dt. 22.06.2018, shpallje e fituesit nga KK-I., Komisioni Vlerësues për dhënien në shfrytëzim të Pronës së Paluajtshmerisë Komunale, Shkresa me nr. 30/2018 e dt. 29.03.2018 shpallje për Ankand Publik për dhënien e Pronës se paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim, Kërkesa për vlerësim profesional e dt. 11.08.2020, Raporti informues sipas autorizimit PPN/I nr.17/20, Kërkesa për marrje të informatave e dt. 07.10.2020, Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim

të pronës Komunale me nr. 30/2018 i dt. 29.03.2018, Lista e pjesëmarrjes së anëtarëve të Komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale me ankand publik në mbledhjen e mbajtur me datë 21.22.06.2018, Shpallja e fituesit nga Kuvendi Komunal – Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të datës 22.06.2018, Raporti i njësisë kadastrale i dt.16.03.2018, Certifikata me nr. P-7080806008-0025-62, Shpallja e ankandit publik me datë 29.03.2018, Vendimi i Kuvendit të Komunës së Istogut me nr. 020-445 i dt. 15.05.2018, Detajet e transaksionit, Certifikata me nr. P-70806057-0028-95 e dt.21.10.2017, Vendimi me nr. 68/2017 i dt.05.05.2017, Vendimi i Kuvendit të Komunës së I. me nr. 020-737 i dt. 15.06.2017, Shpallja e fituesit me datë 22.06.2018, Lista e pjesëmarrjes së anëtarëve të Komisionit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale me ankand publik në mbledhjen e mbajtur me datë 21.22.06.2018, Shpallja e ankandit publik i datës 29.03.2018, Historiati për njësinë Kadastrale 28-95 (ZK) C. dhe 256-2 (ZK V.), Certifikata - Njësia Kadastrale P-70806008-00256-2, Aktvendimi për revokimin e pëlqimit me nr. KE-310-16 E dt. 02.06.2016, Certifikata me nr. UL70806057-00158, Të dhënat bazë për njësinë-prona e paluajtshme P-708060500228-1, Certifikata-njësia kadastrale nr. i lëndës 48352019, Certifikata – njësia kadastrale P-70806057-008660, Kopja e planit e dt.04.10.2019, Aktvendimi me nr. Ref: 542/17 i dt. 25.09.2017, Njoftimi i dt.15.08.2017, Njoftimi i dt. 22.01.2018 i lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Njoftimi për dështim për përmbushje i dt. 11.12.2017 i lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Ekstrakti nga fletë posedimi me nr.3752006 me datë 25.04.2006, Kopja e planit e dt. 24.06.2009, Njoftimi për dështim për përmbushje, Aktvendimi për Pezullim të licencës i dt. 11.12.2017 i lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, Procesverbali me nr.001368 dt.18.04.2018, Vendimi i lëshuar nga Agjencia Pyjore e Kosovës, Foto dokumentacioni, Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës përmes Ankandit Publik me nr. 408/2016 i dt. 16.07.2018, Procesverbali me nr.002362 i dt.29.10.2019, Raporti i njësisë kadastrale i dt.31.10.2019, Certifikata-njësia kadastrale me nr. P-70806057-00865-3, Përgjigje me nr. ref. AKK-02174220 e dt.16.09.2020, Aktgjykimi me nr. A.nr.1722/2017 i dt. 08.10.2019, Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës përmes Ankandit Publik me nr. 403/2018 i dt. 16.07.2018, Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës përmes Ankandit Publik me nr. 402/2018 i dt. 16.07.2018, , Lista e distribuimit e dt. 04.11.2019, Peticioni për ndalimin e përkthyesit të fsh. Vrellë, Vendimi nga Agjencia Pyjore e Kosovës dt.26.05.2017, Vendimi nga Agjencia Pyjore e Kosovës, Ekstrakti i dt.25.04.2006, Lista e distribuimit dt.12.10.2017, Lista - Gjendja e vjetër, Lista – gjendja e re, Skica e matjes në zonën kadastrale Vrellë e dt.05.09.2017, Lista – gjendja e re, Lista – gjendja e vjetër, Kërkesa për regjistrimin e paluajtshmerisë, Aktvendimi i dt. me nr. 867/2017, i dt. 05.10.2017, Vendimi me nr. 68/2017 me dt.05.05.2017, Raportet e kontrollit të cilësisë me dt.06.10.2017, Raporti për editimin e parcelave dhe objekteve përkatëse të parcelës të dt.06.10.2017, Aktvendimi me nr. 248/2018 i dt. 23.03.2018, Pëlqimi me nr. 09 Nr. 320-1184/2009i dt. 03.06.2009, Certifikatat e dt. 25.10.2017, Certifikatat me dt.21.10.2017, Kopja e planit dt. 24.10.2017, Kërkesa e dt.20.03.2018, Licenca për kryerjen e matjeve kadastrale e dt.12.03.2015, Lista – gjendja e re e dt.19.03.2018, Kopja e planit, Certifikatat dt.26.03.2018, Përgjigje ndaj Urdhëresës e dt. 19.10.2020, Lista – gjendja e vjetër, Lista- gjendja e re, Kopja e planit me nr të lëndës 462017 Istog, Raporti për editimin e parcelave dhe objekteve përcjellëse C.- I., Raporti i kontrollit të cilësisë, Aktvendimi me nr. 996/2017 i dt.24.10.2017, Lista-gjendja

e re, Lista- gjendja e vjetër, Përgjigje në kërkesë për informata e dt. 22.10.2020, Kërkesa për dokumentacion me nr. ref. AKK-02-174220 e dt.05.11.2020, Raporti i njësisë kadastrale për zonën kadastrale V. e dt. 16.03.2018, Certifikata dt.16.03.2018, Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale me nr. 24/2018 dt.05.04.2018, Certifikata e dt.21.03.2018, Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale me nr. 25/2018 e dt. 29.03.2018, Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale me nr. 27/2018 e dt. 29.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale zona kadastrale V. e dt.21.03.2018, Certifikata e dt.19.03.2018, Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale me nr. 28/2018 e dt. 29.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale zona C. dt.21.03.2018, Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale me nr. 29/2018, Raporti i njësisë kadastrale dt.21.03.2018, Certifikata e dt.21.01.2017, Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale me nr. 31/2018 e dt. 29.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale dt.21.03.2018, Certifikata e dt.21.03.2017, Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale me nr. 30/2018, Raporti i njësisë kadastrale e dt.21.03.2018, Certifikata e dt.21.10.2017, Vendimi me nr. 77/2018 i dt.21.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale 21.03.2018, Certifikata e dt.23.10.2017, Vendimi i Kuvendit të Komunës së dt.02.05.2018, Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale me nr. 26/2018 me dt.29.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale dt.16.03.2018, Certifikata dt.06.10.2017, Vendimi i Kuvendit të Komunës së Istogut me nr. 020-445 i dt. 16.04.2018, Vendimi –Formimi i komisionit vlerësuese për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshmërisë Komunale, Vendimi –formimi i komisionit për ankesa me nr. 20/2018 i dt. 05.04.2018, Vendimi i APK-ja i dt. 05.05.2017, Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale me nr. 30/2018 e dt. 29.03.2018, Vendimi i Kuvendit të Komunës i dt. 02.05.2018, Vendimi me nr. 72/2018 i dt. 21.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale i dt.21.03.2018, Certifikata e dt. 19.03.2018, Vendimi me nr. 73/2018 i dt. 21.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale i dt.16.03.2018, Certifikata e dt. 06.10.2018, Vendimi me nr. 74/2018 i dt. 21.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale i dt.16.03.2018, Certifikata e dt. 06.10.2018, Vendimi me nr. 75/2018 i dt. 21.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale i dt.29.03.2018, Certifikata e dt. 19.03.2018, Vendimi me nr. 76/2018 i dt.21.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale i dt.21.03.2018, Certifikata e dt. 21.07.2017, Vendimi me nr. 78/2018 i dt. 21.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale i dt.21.03.2018, Certifikata e dt. 21.10.2017, Vendimi me nr. 79/2018 i dt. 21.03.2018, Raporti i njësisë kadastrale i dt.21.03.2018, Certifikata e dt. 21.10.2017, Raporti i Auditimit për pasqyra financiare të Komunës së I. për vitin 2019, Raporti i Auditimit për Komunën e Istogut për vitin financiar të përfunduar me 31. Dhjetor 2018, Raporti i Auditimit për Pasqyrat Financiare vjetore të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2017, Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshmërisë të Komunës përmes ankandit publik me nr. 402/2018 i dt.16.07.2018, Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshmërisë të Komunës përmes ankandit publik me nr. 403/2018 i dt.16.07.2018 Kontrata për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshmërisë të Komunës përmes ankandit publik me nr. 401/2018 i dt.16.07.2018, Procesverbalet e dt. 29.03.2018 i mbajtur në sallën e KK-I., Vendimi për Themelimin e KKSb-së, Procesverbali i dt.12.02.2018, Raporti vjetor Financiar për vitin e përfunduar me 31. Dhjetor 2017, Procesverbali për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake të dëmtuarin –dëshmitarin B. Z. me dt. 25.11.2020, Procesverbali për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake dëshmitarin Q. B. me dt. 25.11.2020, Procesverbali për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake dëshmitarin H. B. me

dt. 20.01.2021, Procesverbali për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake dëshmitarin Z. S. me dt. 08.01.2021, Procesverbali për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake dëshmitarin H. K. me dt. 08.01.2021, Certifikatat e dt.23.04.2020, Kërkesat për dokumentacion me nr. ref. AKK-02-174220 dt.09.11.2020 dhe 05.11.2020, Përgjigja sipas kërkesës DHKEK 2020 ke -115 të dt.16.10.2020, Njoftimi për shpenzimet e derivateve për muajin Gusht 2020 në nivel Drejtorati i dt. 30.10.2020.Kontrata për qiranë e Tokës Pyjore e dt. 14.09.2017, Pëlqimi me nr. ref. KE52917 dt.12.09.2017, Kërkesa për vazhdimin e kontratës e dt. 11.07.2017, Kërkesa për vazhdimin e kontratës e dt.13.07.2017, Njoftimi me ngastër kadastrale 77/76 i dt.11.06.2008, Kopja e planit dt.12.06.2008, Certifikatat e dt.16.01.2013, Kërkesa për shfrytëzimin e inerteve pyjore e dt.11.07.2017, Sigurimi i përmbushjes së detyrimeve tjera me nr.037432, Informata mbi biznesin me nr. të biznesit 80079206, Vërtetimi tatimor i dt.11.07.2017, Certifikata e regjistrimit me nr.l biznesi 80079206, Vërtetimi i dt.31.01.2014, Kontrata për shfrytëzimin e përkohshëm të tokës pyjore e dt.17.07.2008, Certifikata e nr fiskal e dt. 20.11.2009, Kërkesa e dt.07.04.2017, Pëlqimi për shfrytëzimin e gëlqereve e dt.27.08.2008, Projekti për ri kultivimin e ngastrës në vendin e quajtur Mali i fshatit i dt.14.04.2008, Shpallja e fituesit me nr. rendor 62/2018 e dt.22.06.2018, Listat e distribuimit e dt.07.09.2017, Vendimi i Kuvendit Komunal me nr.020-737 i dt.15.06.2017, Vendimi i Kuvendit të Komunës së I. i dt.15.06.2017, Vendimi me nr.66/2017 i dt.05.05.2017, Certifikata e datës 16.01.2013, Kopja e planit e dt.25.06.2013, Certifikatat e dt.16.01.2013, Kopja e planit e dt.16.07.2013, Vendimi i Kuvendit të Komunës së I. dt.15.06.2017, Vendimi me nr.65/2017 i dt.05.05.2017, Listat e distribuimit e dt.17.09.2017, Vendimi i dt.15.06.2017, Vendimi me nr.68/2017 i dt.05.05.2017, Vendimi me nr. 66/2017 i dt.05.05.2017, Kopja e planit dt.25.06.2013, Certifikatat e dt.16.01.2013, Procesverbali për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake të pandehurin I.H.me dt. 28.04.2021, Procesverbali për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake dëshmitarin I. H. me dt. 27.11.2020, Përgjigja në shkresën PP/I nr. 164/20 të dt. 14.06.2021, Përgjigja në kërkesë të dt. 26.11.2020, Procesverbali i dt. 21.06.2018, Procesverbali për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake të pandehurin L.B. me dt. 30.04.2021, Procesverbali për marrjen e deklaratës në procedurë paraprake të pandehurin I.H.me dt. 05.05.2021. Provat e propozuar nga mbrojtësi i pandehurit Ismet Hasi, vendimi i Kuvendit Komunal në Istog, me nr. 01 63/21, i dt. 29.06.2021, vendimi i Kuvendit Komunal në Istog, nr. 65/21, i dt. 29.06.2021, vendimi i Kuvendit Komunal në I. nr. 66/21, i dt. 29.06.202, dhe prova e propozuar nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar, raporti i komisionit ndërministror i dt. 09.07.2020

Gjatë seancës gjyqësorë është dëgjuar përfaqësues i autorizuar i palës së dëmtuar, Agjencionit Pyjor të Kosovës, në cilësi të dëshmitarit B. Z., i cili nder të tjera ka deklaruar se, prej vitit 2015 e deri me tani është në pozitën e Drejtorit të Drejtoratit Qendror të Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti. Prej vitit 2017, e në vazhdimësi edhe në vitin 2018 kanë zhvilluar inspektime në disa prej të cilave ka qenë prezent e në disa ka qenë udhëheqës i ekipeve të inspektionit dhe kanë konstatuar, veprime ilegale të këtyre dy operatorëve ekonomik dhe disa të tjerë në zonën kadastrale V. dhe C.në Komunën e I. , në afërsi të fshatrave L. dhe V.. Veprimet ilegale të konstatuara kanë qenë sepse kanë operuar pa kontrata duke shmangur obligimet e pagesave prej 20 cent për m2, në vit, që i bie 2000 euro për një hektar në vit, pa plan të ri kultivimit të sipërfaqes së shfrytëzuar dhe kthimin në gjendje të mëparshme pas përfundimit të shfrytëzimit. Tek njëri operator- madje nuk ka poseduar as pëlqim për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës

pyjore, pa të cilën asnjë pronë publike por as edhe private me kulturë mal ose tokë pyjore, nuk guxon të shfrytëzohet, për këtë arsye kanë nxjerr vendime të cilat nuk i kanë zbatuar dy operatorë ekonomik. për çka kanë ushtruar këtë paraqitje për moszbatimit të vendimit që konsiderohet vepër kundërvajtëse. Kanë vendosur edhe shiritat për mos lejimi e vazhdimi të punimeve dhe heqja e tyre përbën vepër penale, për çka kanë ushtruar kallëzime penale ndaj dy operatorëve ekonomik, të cilat janë hudhur poshtë me arsyetimin se shiritat nuk është konstatuar se kush i ka heq shiritat dhe ka qenë konstatimi se këta operator kanë pasur licenca prej KPM-së. Kanë kërkuar nga komisioni për miniera dhe minerale që këto licenca të revokohen për operatorin ekonomik dhe SHPK deri në pajisje me pëlqim për ndërrimin e destinimit të pyjeve dhe tokave pyjore nga Agjencioni pyjor i Kosovës, si institucion kompetent. Në vitin 2018 kanë zhvilluar prapë inspektime dhe kanë konstatuar se këta operator ekonomik kanë vazhduar punimet në mënyrë ilegale pa asnjë dokumentacion, pa kontrata dhe tani as pa licencë të punës nga KPMM, madje operatori ekonomik SHPK edhe pa pëlqimin e APK-së, i cili ishte revokuar. Komuna e I. dhe të gjitha Komunat e Republikës së Kosovës, kanë të deleguara kompetencën e mbrojtjes së pyjeve, sipas ligjit nr. 03L-153, për ndryshimin e plotësimin e ligjit nr. 2003/3, për pyjet e Kosovës, Kompetenca e Komunës duke referuar ligjit të lartcekur, ka pasur dhe ka kompetencë, vetëm në mbrojtjen e pyjeve, kurse kompetencat tjera të menaxhimit të përgatitjes së planeve vjetore dhe 10 vjeçare, lidhjen e kontratave për dhënien në shfrytëzim të pyjeve dhe tokave pyjore e ka Agjencioni Pyjor i Kosovës, pasi me ligj, pyjet janë pasuri e shtetit të Kosovës, se Komuna nuk e ka pas një kompetencë të tillë. E kanë edhe një njoftim të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si institucion që vlerëson ligjshmërinë e vendimeve të nxjerra nga Ansambletë Komunale, të dt. 15.06.2017 me nr. 020737, ku konstaton se akti i Komunës së I., apo vendimi për dhënien me qira këtyre operatorëve ekonomik tek këto prona është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. I kanë pas në dispozicion atë vendim për operatorin, dhe, të nxjerra nga Komuna e I., si vendime të kundërligjshme dhe si rezultat e kanë njoftimin nga MAPL-ja që ato vendime të Komunës së Istogut kanë qenë me kundërshtim me ligjin. Në secilin rast kur në lista poseduese kultura është pyll, ose tokë pyjore dhe ajo pronë shfrytëzohet për diçka tjetër, jashtë destinimit që ka të përcaktuar me dokument kadastral, duhet të këtë pëlqim për lejimin e ndërrimit të destinimit nga agjencioni pyjor i Kosovës, jo vetëm për prona publike por edhe për prona private, kjo është e rregulluar me udhëzimin administrativ 10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin të udhëzimit administrativ 41/2006, për ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore, akt administrativ që derivon nga ligji për toka bujqësore, në këtë rast ka bërë shkëlqje sepse nuk ka qenë kompetent. Në vitin 2019, kanë pasur një aksion në nivel vendi me drejtorinë për hetimin e krimeve të rënda, me KPMM-në, me stacionet policore Komunale, me inspektoriatet e MMPH-së, qëllimi i këtij inspektimi ka qenë identifikimi i degradimit të ambientit , shkatërrimit të shtretërve të lumenjve, gurorët dhe gjatë kontrollës tek këta dy operatorët ekonomik, ju janë prezantuar inspektorëve kontrata të lidhura nga Komuna dhe gjatë kontrollës kanë verifikuar se aty ka ndryshime të kulturës ku nuk rezultojn me kultura pyll , as nuk ekziston ngastrada kadastrale 28/1, që ka qenë duke shfrytëzuar SHPK dhe kanë ngrit dyshimet se këto dokumente janë të falsifikuar për faktin se ishin të njëjtat ngastrada, por që tani nuk rezultojn kultura pyll te lista poseduese dhe kopjet e planit dhe ky falsifikim ishte bërë me qëllim që të shmanget domosdoshmëria ligjore që të pajisen me pëlqim për ndërrimin e destinimit të përkohshëm nga kultura pyll në shfrytëzim të mineraleve në mënyrë që të pajisem me licencë nga KPMM-ja, pasi në raste kur nuk është kultura pyll apo tokë pyjore,

KPMM-ja nuk kërkon pëlqim nga agjencioni dhe si rezultat këta dy operatorë ekonomik kanë marr licencat nga ky institucion. Te gjitha pyjet dhe tokat pyjore të shpallura sipas ligjit pronë e shtetit të Kosovës, menaxhohen dhe administrohen nga Agjencioni Pyjor i Kosovës dhe lidhur me këtë hartohen planet menaxhuese afatgjate 10 vjeçare për secilën njësi menaxhuese , po ashtu një plan të tillë ka pasur edhe njësia menaxhuese Lugu i Butë. Komuna e I. nuk ka pas të drejtë me i jap në shfrytëzim ngastrat që ndodhen në Lugun e Butë. Dhënia në shfrytëzim e pyjeve dhe tokave pyjore dhe nderimi i destinimit të tyre është kompetencë e APK-së dhe kjo është e rregulluar me udhëzimin administrativ 10/2010, për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ, 41/2006, për nderimin e destinimit të tokës bujqësore. Me rastin e dhënies së sipërfaqes prej 5 ha, njësia kadastrale 28/1, në ZK C., po ashtu në ZK L. në sipërfaqe prej 56.799 m², nuk janë përfillur këto procedura dhe këtë e kanë vërejtur gjatë inspektimit të vitit 2019, me institucionet tjera si KPMM, MMPH , policisë dhe Drejtorisë së Hetimeve të Krimeve të Rënda, ku u janë prezantuar kontrata e që në fakt nuk figuronte ngastra 28/1, por ishin ndryshuar në ngastra tjera. I kanë marr këto kontrata me këto dyshime , i kanë obliguar inspektorët që të zhvillojnë një kontroll, të hartojnë një procesverbal me konstatimet se a është i njëjti lokacion ku është duke u shfrytëzuar për gurore nga operatori ekonomik SHPK dhe të njëjtit kanë konstatuar se lokacioni është i njëjti por nuk figuron ngastra 28/1, por tani është një ngastër krejtësisht tjetër, madje ajo ngastër për të cilën kishte kontratë me Komunë, që figuronte ngastra 28/92, në fakt ishte krejtësisht ngastër tjetër, afërsisht 200 metra larg vendit ku shfrytëzoheshin mineralet , pra ishte ngastra 872 dhe këto konfirmime edhe për tri ngastra tjera 28/95, në fakt jo që nuk ishte në kuadër të këtij lokacioni, po ishte zonë banimi. Njëjtë si ngastra 28/94, prapë zonë banimi, 28/93, figuronte rrugë, edhe pse në nenin 2 të kontratës, konstatohet se prona do të shfrytëzohet për përdorimin e gurit gëlqeror dhe rërës, a këto ngastra në fakt janë zonë banimi dhe janë të konfirmuara zyrtarisht me një raport nga Drejtoria koordinuese regjionale P.. Ndryshimi i destinimit nga kultura pyll , ose tokë pyjore, ka ndodhur për tu shmangur nga domosdoshmëria e marrjes së pëlqimit nga agjencioni pyjor i Kosovës për ndërrim të destinimit pasi për çdo rast ku kultura është pyll, apo tokë pyjore , publike apo private, nuk ka askush brenda në nivel vendi ti lejojë ndërrimin e destinimit, përveç APK-së, kurse pas këtij ndërrimi ju ka mundësuar që të marr licencë nga KPMM-ja, sepse ata nuk e kërkojnë pëlqimin nga APK-ja, në rast se nuk ekziston kultura pyll apo tokë pyjore. Si pasojë e këtyre veprimeve 288 hektarë e 70 ari e 63m², të evidentuara si pyje dhe toka pyjore si resurse kombëtare kanë humbur dhe nuk rezultojnë më.

Dëshmitari, H. B., në seancën e shqyrtimit gjyqësor deklaroi, se shumë pak i kujtohet se çka ka deklaruar në prokurori, mirëpo e ka thënë të vërtetën. Nga dt. 29.06.2020, e deri në fund të vitit 2021 kur ka dal në pension ka qenë drejtor i Kadastrës. Para vitit 2020, ka qenë shef i kabinetit të Kryetarit të Komunës në I., nga viti 2018 e tutje derisa është emëruar drejtor i kadastrit. Ndërsa Kryesues i Kuvendit Komunal nga viti 2014, deri në fund të vitit 2017. Gjatë kohës sa ka qenë Kryesues i Kuvendit, Kuvendi me propozim të Kryetarit ka marr vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të sipërfaqes prej 5 hektarësh nga njësia kadastrale 28/1 në ZK, X. PSHSH e mirë e fshatit. Propozimi i Kryetarit ka qenë nënshkruar dhe i vulosur dhe ka ardhë ne formë te shkruar. Sa i kujtohet ka qenë në pyetje, përfaqësues i të cilës ka qenë I.R., Kryetari H. R., e ka pas vëlla I. R.. Baza për marrjen e këtij vendimi për dhënien në shfrytëzim, ka qenë udhëzim administrativ, i vitit 2013, neni 9 sa i kujtohet dhe ligji për dhënien në shfrytëzim dhe

këmbim të pronës së paluajtshme Komunale të vitit 2010. Nuk e din a ka qenë seanca e njëjtë kur janë marr këta dy vendime, mirëpo e dinë që është marr vendim për dhënien në shfrytëzim të sipërfaqeve të cekura më lartë. Me lejen e trupit gjykues Prokurori ia ka afruar dëshmitarit, në shikim deklaratën e dt. 20.01.2021, në faqen 4 nga 7, pasusi 6 dhe 7 keni deklaruar:” përgjigja e MAPL-së, ka qenë që këto vendime në kundërshtim me ligjin dhe duke i dhënë arsytimin se me cilat ligje nuk ka qenë në përputhje këto vendime, pasi që e kemi përgjigjen nga MAPL, është dashur që prapë ta qesim në kuvend dhe ta rishqyrtojmë dhe ta harmonizojmë vendimin me vërejtjet të cilat janë dhënë. Në këtë periudhë kohore janë mbajtur zgjedhjet dhe edhe pse e kemi kthyer në rishqyrtim vendimin atëherë Kryesues është caktuar Q. B. dhe çka ka ndodh më tutje , pyeteni z. Q.”, a është e vërtetë kjo çka keni deklaruar në prokurori. Dëshmitari përgjigjet se, po e vërtetë është kjo. Gjeodeti i licencuar ka të drejtë të bëjë ndërrimin e kulturës, apo llojit të shfrytëzimit të tokës në bazë të udhëzimit administrativ të vitit 2013 nenit 9, gjeodeti ka të drejtë me kërkesë të palës ta bëjë ndërrimin e kulturës. Pas vendimit të MAPL nuk e di se çka ka ndodh pastaj, sepse nuk ka qenë më në pozitën e Kryesuesit. Në kohën kur dëshmitari H. B. është zgjedhur drejtor i kadastrës, I.H. ka qenë shef i kadastrës, sektorit të gjeodezisë. Vendimet e ansambles duhet të zbatohen , ndërsa konstatimet e gjeodetit të licencuar nuk mundën as të pranohen as të refuzohen apriori, pa i plotësuar kushtet

Dëshmitari, H. K., në seancën gjyqësore deklaroi se, qëndron pranë deklaratës së dhënë në Prokurori, me dt. 08.01.2021, dhe ka shtuar se, që nga paslufta ka punuar në Drejtoratin për gjeodezi dhe kadastrë në I. deri në vitin 2009, ku është licencuar në ministri dhe që nga atëherë punon si gjeodeti i licencuar. Detyrat e tij janë që me kërkesë të palëve e në përputhshmëri me ligjin mbi kadastrë të bëjë azhurimin e ndarjeve në pjesën grafike dhe tekstuale. Ka të drejtë të bëjë edhe prona private, edhe prona shtetërore nëse dikush nga palët ka fitu të drejtën e shfrytëzimit të pronës. Dëshmitari ka theksuar se e ka bërë parcelizimin e parcelës 28/1, e cila evidentohet si pronë shoqërore e mirë e fshatit X., me kërkesë të përfaqësuesit të Kompanisë Ka pasur dy vendime, një vendim-pëlqim i drejtoratit për bujqësi K. I., të vitit 2009 dhe vendimin e Kuvendit Komunal në I. të vitit 2017, mirëpo nuk ka qenë në dijeni që për këtë vendim të pronarit i është revokuar licenca dhe pëlqimi për shfrytëzimin e kësaj parcele. Por kur ka shku në terren e ka pa se Kompania është në shfrytëzim të kësaj parcele. Me vendimin e Kuvendit të vitit 2017, i dt. 05.05.2017, në pikën 5 shkruan që pas zgjedhjes së Kompanisë nga komisioni vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes të cekur nën pikën 1, e në pikën 1, shkruan 5 ha, të parcelës 28/1. Ka shtuar se me përkufizim e kupton kur një parcele ekzistuese duhet të gjinden kufijtë, kurse në rastin konkret parcelës së përshkruar në vendim kërkohet matja dhe llogaritja e sipërfaqes prej 5 ha, e cila regjistrohet në laboratin kadastral pa ndryshime në pronarë, ndërsa parcelizimi është vendosja e kufijve të ri të 5 hektarëshit, meqenëse nuk ka pas kufi të vjetër. Parcelizimin e ka bërë, sipas udhëzimit administrativ 02/2013, neni 9. Nëse parcela është mal i pyllëzuar, parcelizimin prapë ka drejtë me e bo gjeodeti për me pëlqimin e autoritetit pyjor, në rastin konkret nuk e ka pas pëlqimin e autoritetit pyjor, për shkak se ditën e matjes aty nuk ka pas pyll, por vetëm gurë çka dëshmohet me orto foto, parcela me nr. 28/1 ka qenë mal i klasës së tretë. Dëshmitari ka shtuar se është e saktë ajo që ka deklaruar në Prokurori se “ Komuna pikërisht drejtoria për kadastrë dhe gjeodezi ka të drejtë ndërrimin e klasave të tokës, duke filluar nga klasa 6 e tutje, kurse nga klasa 1 deri 6 bie në kompetencën e Ministrisë”. G. R. ka pasë të drejtë me bo kërkesë në gjeodezi për ndërrimin e kulturës nga mal-klasi tretë, në tokë tjetër sipas

gjendjes faktike, ky parcelizim që e ka bërë, me kërkesën e palës G. R., është bërë në ZK X., në të njëjtin vend ku tani ndodhet gurëthyesi. Me parcelizimin e pronës 28/1, janë nda ngastrat dhe numrat e ngastrave, në parcelën 28/1 me kulturë mal i klasit 3 ka pasur 282 ha, 70 ari dhe 63 m², në parcelizimin është formu parcela 28/90, me kulturën mal të klasit të tretë 277 ha, 70 ari, 63 m² dhe parcela nr. 28/91, mal i klasit të tretë 5 ha. Nga parcela 28/91, janë fituar parcelat nr. 28/92, 28/93, 28/94 dhe 28/95, janë me kultura të ndryshme. Pasi që e kanë bërë këtë ndarje janë regjistruar në zyrën kadastrale. Në vitin 2018, është bërë bashkimi i parcelave 28/92,93,94 dhe 95 me kërkesën e Kompanisë Në pyetjen e mbrojtësit te të pandehurit I.H., av. N. D.se “a keni pas njohuri se vendimi i asamblesë Komunale i dt. 05.05.2017, me të cilin ju ka dhënë në shfrytëzim parcela në fjalë Kompanisë është ndryshuar nga MAPL” dëshmitari është përgjigjur se “nuk kam qenë në njohuri për vendimet e Ministrisë” ndërsa në pyetjen e Kryetarit të trupit gjykues “parcelizimin me nr. 28/91, 28/92, 28/93, 28/94 dhe 28/95, kush e ka bërë”, dëshmitari është përgjigjur “e kam bërë unë në bazë të kërkesës së Kompanisë, në bazë të gjendjes faktike në terren dhe shfrytëzimit aktual.

Dëshmitarja, Z. S., gjatë seancës gjyqësore, deklaroi se qëndron pranë deklaratës të dhënë në Prokurori me dt. 08.01.2021. Në vitin 2018 ka punuar si udhëheqëse e zyrës ligjore ku punon edhe tani. Zyra e saj ka qenë nën kompetencë të drejtorisë për administratë Komunale, kompetencat e saj kanë qenë në bazë të përshkrimit të detyrave të punës. Vendimet që janë marr nga Kryetari, i ka përpiluar dëshmitarja Z., mirëpo kanë përpiluar edhe drejtoritë tjetër varësisht nga natyra e punës çka është kërkuar. Asnjëherë nuk është kërkuar nga e njëjta që të përpilojë autorizime për Kryetarin H. R. apo ne emër te Kryetarit H. R.. Autorizime nga Kryetari ka pas vetëm për automjete me e leju Kryetari ndonjë zyrtari automjetin me marr me shku në trajnim. Librin e protokollit të Kryetarit e ka mbajtur dëshmitarja. Me dt. 18.04.2018, nuk kanë protokolu ndonjë autorizim në këtë libër dhe kopje është edhe protokollit i kësaj date. Pasi që prokurorja ia ofron në shikim autorizimin zyrtarisht /2018, të dt. 18.04.2018, dhe e pyet dëshmitaren se “a lëshohet çdo autorizim nga Kryetari në këtë formë” dëshmitarja përgjigjet se, “autorizimi, apo dokumenti në fjalë duhet të përmbajë numrin e protokollit”. Dëshmitarja deklaroi se nuk e ka përpiluar dhe nuk e di se kush e ka përpiluar këtë autorizim ne emër te Kryetarit.

Dëshmitari, I. H., ne seancën gjyqësore deklaroi, qëndron pranë deklaratës së dhënë në Prokurori me dt. 27.11.2020. Në vitin 2018 ka qenë drejtor i urbanizimit, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit në Komunën e I., nga viti 2010 deri në Korrik të vitit 2018. Nga Korriku i vitit 2018, ka kaluar si drejtor për planifikim urban të mbrojtjes së mjedisit deri në fund të Tetorit të vitit 2018, nga Tetori i vitit 2018 deri në Shkurt të vitit 2019, ka qenë i papunë. Ka njohuri gjatë vitit 2017-2018, për vendimet e asamblesë Komunale për prona që janë dhënë në shfrytëzim të përkohshëm kompanive SHPK dhe SHPK në V. dhe X.. Sa e din nuk ka të drejtë askush të bëjë ndërrimin e klaseve vetëm organet më të larta pranë Ministrisë, ndërsa ndërrimin e kulturave e cila dallon mes klasave, kulturën mund ta bëjnë edhe gjeodetët në terren, p.sh. ara mund të bëhet livadh, dhe anasjelltas. Me lejen e trupit gjykues prokurorja ia ofron në shikim vendimin me nr. prot. 867/17, të dt. 05.10.2017, të ZK V. dhe e pyet a është nënshkrimi i tij kështu, Dëshmitari deklaroi se nuk është nënshkrimi i tij këtu, mirëpo në bazë të përvojës që ka punuar me I.H., është nënshkrimi i I. H.. Dëshmitari deklaroi se nuk e din a ka pas të drejtë I.H.me nënshkru për të, ai ka qenë zyrtar ligjor dhe ka nënshkru edhe në vendime kur dëshmitari I. H. nuk kam qenë

prezent, ndërsa këtë vendim nuk mund të thotë se a ka pas të drejtë apo jo ta nënshkruaj I.H.. Pasi që prokurorja ia ofron në shikim aktvendimi me nr. prot 13665/2018, me nr. të lëndës 248/18, dt. 23.03.2018, që ka të bëjë me parcelimin e pronave në njësinë kadastrale në X. dhe e pyet a është nënshkrimi juaj në këtë vendim, dëshmitari është përgjigje “ jo nuk është”, mundet me qenë i zyrtarit I. H.. Pasi që prokurorja ia ofron në shikim aktvendim me nr. prot 996/2017, ZK-X., dt. 24.10.2017, e që ka të bëjë me parcelizimin e pronës dhe regjistrim në RDPP, sipas regjistrimit të terrenit 3/2017 për njësitë kadastrale 28/92, 28/93, 28/94 dhe 28/95, dhe e pyet dëshmitarin se kujt është nënshkrimi, dëshmitari I. H. është përgjigjur se “nënshkrimi nuk është i imi por është i I. H.”. Dëshmitari I. H. po ashtu ka deklaruar se I.H. nuk i ka dhënë nënshkrimet në prezencën e dëshmitarit I., pasi që nuk e ka pa asnjëherë se ka dhënë nënshkrime për dëshmitarin në prezencën tij dhe nuk e di se a ka qenë në punë apo jo në atë kohë. Në pyetje të gjykatës se “në kohën kur keni qenë drejtor dhe I.H. është nënshkruar për ju, a e keni ditë në atë kohë se udhëheqësi i sektorit I.H. është duke nënshkruar për ju dhe a i keni dhënë ju ndonjëherë autorizim që të nënshkruaj për ju” dëshmitari është përgjigjur “jo nuk e kam ditë dhe nuk i kam dhënë ndonjëherë autorizim për të nënshkruar për mua”.

Dëshmitari F. B.gjatë seancës gjyqësore deklaroi, nga 1 Gushti i vitit 2017 e deri në Maj të vitit 2021, ka qenë duke punuar në pozitën e zyrtarit ligjor, në kuadër të drejtorisë për Gjeodezi dhe kadastër. Prej 1 Gushtit të vitit 2017, deri me 1 Gusht 2018, pra 12 muaj, ka qenë periudha provuese. Më tepër si detyrë e ka pas për me u marr me uzurpimin e pronave Komunale, për derisa çështjet kadastrale për të cilat ka qenë i ngarkuar I.H. në pozitën e udhëheqësit, kanë qenë të aspektit kadastral. Lidhur me parcelën 28/95 ZK X., edhe pse ka qenë në periudhë provuese një vjeçare, zhvillimi i procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, është zhvilluar gjatë muajve Mars, Maj dhe Qershor, të vitit 2018. Pra përkundër që ishte në periudhë provuese është ngarkuar me detyra të ndryshme për zhvillimin e ankandit publik, për dhënien në shfrytëzim të pronave të Komunës, përfshirë edhe njësinë kadastrale 28/95. Ligji për dhënien në shfrytëzim e parasheh që të drejtën e inicimit të procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronave të Komunës, i takon Kryetarit të Komunës si përfaqësues i Komunës dhe këtë e dëshmon propozimi –vendimi i Kryetarit të Komunës. Lidhur me parcelën 28/95, nuk ka njohuri për veprimet e zyrtarit , këtu të pandehurit I.H., para propozimit të Kryetarit. Propozimi i Kryetarit është prezantuar në Kuvendin e Komunës për miratim nga ansambleistet dhe me shumicë votash është miratuar, me dt. 29.03.2018, me miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës, nuk përcaktohet fituesi, ky propozim vetëm e hap mundësinë e dhënies në shfrytëzim të pronës së Komunës, përmes ankandit publik. Pas miratimit të këtij propozimi është procedura ligjore që të shkojë në ministrinë e administratës publike – MAPL, për konfirmimin ose jo të ligjshmërisë. Dhe brenda afatit prej 15 ditësh, MAPL ka obligim ligjor që të kthejë përgjigje. Nga konfirmimi i MAPL-së kanë marr përgjigje pozitive sipas përgjigjes me nr. 020-445/33, të dt. 21.05.2018. Pasi ju ka dorëzuar konfirmimi pozitiv i ligjshmërisë, së bashku me certifikatën pronësore dhe kopjen e planit, për njësinë kadastrale 28/95, e ka hartuar ankandin publik. Ndër ofertuesit kanë qenë dhe Ka pas edhe ofertues tjerë mirëpo tani nuk i kujtohen. Nuk ka qenë në dijeni se operatori ekonomikka qenë duke operuar në të njëjtë parcelë edhe para shpalljes së ankandit publik. Më vonë e ka kuptuar, nga pretendimi pronësor të cilën e ka paraqitur Agjencioni Pyjor i Kosovës. Madje ky pretendim pronësor ishte paraqitur dy muaj para punësimit të tij pozitën zyrtar ligjor, e për të cilin

informacion askush nuk e ka njoftuar. Pas caktimit të fituesit, për njësinë për të cilën po bëhet fjalë, veprimi tjetër i radhës ka qenë lidhja e kontratës në mes të Komunës si qiradhënëse dhe fituesit të ankandit si qiramarrës në këtë rast, në emër të Komunës si qiradhënëse kontratën e ka nënshkruar L.B.. Aty kanë qenë 8 kontrata të ndryshme, për njësi kadastrale të ndryshme, dhe në mesin e tyre ka qenë edhe kontrata nr. 01404/2018 dhe vetëm pasi ka ndodh ky rast, e ka kuptuar që nënshkrimi nga L. është dhënë me qëllim të shmangies së konfliktit të interesit nga H. R., ish Kryetari me vëllain e tij në këtë rast G.R.. L.B. në atë kohë ka qenë nënkryetar i Komunës. Vetëm pasi ka ndodh rasti, e ka lexuar nga ligji për anti korrupsionin që Kryetari ka pas obligim ligjor ta njoftojë me shkrim Agjencionin anti korrupsion për ekzistimin e konfliktit të interesit, kurse se a i ka dhënë dikujt autorizim Kryetari nuk ka njohuri. Në vitin 2018 nuk ka kërkuar askush që dëshmitari F.B. me përpilu autorizim. Në muajin Mars të vitit 2020, polici hetues H.Xh., ka ardh tek dëshmitari në zyrë dhe ka kërkuar dosjen për njësinë kadastrale 28/95 si dhe një dosje për Kompaninë, brenda 5 ditëve, i ka kompletuar dosjet e kërkuara nga hetuesia. Pastaj e ka lajmëruar në telefon policin H., që të vijë ti marr dosjet e gatshme, por filloi periudha e pandemisë në Mars të vitit 2020, dhe në muajin Korrik, ka ardhur ti marr dosjet e kërkuara. Gjatë muajit Tetor, të vitit 2020, ka ardhur prapë polici H. dhe e ka pyet se a ke diçka shtesë për të dorëzuar nga ato që ja ka dorëzuar më herët, dëshmitari i ka thënë që -jo të gjitha që i ka pas i ka dorëzuar. Pas përfundimit të kësaj bisede polici H., e ka pyet ku është zyra e L.B.t. Të nesërmen, me 07 Tetor të vitit 2020, në orën 08:11 në mëngjes, dëshmitari F. B. është takuar me L.B. në korridorin e Komunës dhe i cili i ka thënë që ja ka dërguar në email një autorizim dhe nëse kërkon duhet me printu, dhe me ia dërgu Kryetarit për nënshkrim. Edhe pse L.B. e ka pas emailin zyrtar të dëshmitarit F., L.B. autorizimin ja ka dërguar dëshmitarit në emailin privat të gatshëm me bazën ligjore. Autorizimi është dërguar në formatin e Wordit dhe në të ka qenë e shënuar zyrtarisht /2018, e dt. 18.04.2018. L. në autorizim ka kërkuar të futen numrat e kontratave si dhe ti printohet dhe ti dërgohet Kryetarit për nënshkrim dhe vulosje. Dhe po atë ditë, diku rreth orës 14:00, ka qenë duke u intervistuar L.B. nga policia hetimore në Prishtinë. L. e ka thirr rreth orës 14:00 në telefon dhe i ka thënë printoje autorizimin . Dëshmitari F. e ka printuar e ka dërgu tek Kryetari për nënshkrim dhe vulosje, por Kryetarin personalisht nuk e ka takuar dhe atë autorizim të printuar, ia ka dhënë shefit të kabinetit të Kryetarit V. L., i cili pastaj e ka kthyer autorizimin tek dëshmitari të nënshkruar dhe të vulosur. Në autorizimin që ia ka dërguar L.B., dëshmitari ka futur numrat e kontratave, pasi që gjatë takimit në mëngjes me L. i njëjti i ka thënë me i fut numrat e kontratave dhe me e kompletu autorizimin. Dëshmitari ka shtuar se L. i ka thënë se ekziston një autorizim i tillë, por nuk po mundet ta gjejë për momentin. Dëshmitari shtoi se nuk e ka pas idenë që me veprimet e tij po inkriminohet me kryerjen e ndonjë veprë penale. Nga autorizimi që ia kishte dërguar me email L. , ai po ashtu i ka dhënë edhe sqarimin që ai duhet të mbetet zyrtarisht /2018, me dt. 18.04.2018. Autorizimet e tilla zyrtarisht nuk ka pa asnjëherë, por në shkresat e ndryshme të komunikimit mes kolegëve, i ka rastis të shoh fjalën zyrtarisht, tek protokollit sa që i është dukur diçka normale sepse iu ka referuar komunikimit zyrtar. Pasi ka ndodh rasti e ka kuptuar që ky autorizim nuk ka ekzistuar fare në vitin 2018 prandaj edhe i është vendos fjala zyrtarisht. Pasi që autorizimi është nënshkruar dhe vulosur nga Kryetari, dëshmitari pasi që e ka pranuar autorizimin e tillë të njëjtin e ka skanuar dhe ia ka dërguar policit H. Xh., sipas kërkesës së L.. Atë ditë ka qenë duke u intervistuar në Prishtinë L.. Të nesërmen ditë e premtë ka qenë , ka ardhur në komune polici hetues H. me një koleg, dhe ka kërkuar informacion për atë autorizim. Gjatë qëndrimit të tij në zyrë, e mban mend

që e ka thirr polici H., L. në telefon, dhe kur e ka pyet për autorizim, e din që përgjigja e L. ka qenë që unë nuk jam në dijeni për atë autorizim, me atë është marr F., sqarohuni me të. Dëshmitari aty e ka kuptuar që të gjitha veprimet e L. janë bërë me një planifikim paraprak të mirë organizuar, sepse e ka pas mundësinë atë autorizim ta printojë vet, por nuk e ka bërë një gjë të tillë por ia ka dërguar dëshmitarit F.B..

Prokurori i Shtetit Valbona Disha Haxhosaj, në fjalën përfundimtare ka theksuar, se i pandehuri L.B. ka kryer veprën penale falsifikim i dokumentit zyrtar nga neni 427 par. 1 të KPRK-së, bazohet në provat materiale si: në autorizimin e falsifikuar zyrtarisht /2018 te dt. 18.04.2018 e te vërtetuar nga deklarimi i dëshmitarit njeherit zyrtarit F. B. të dhënë në prokurori. Se i pandehuri ka kryer këtë veprë penale prokurori i shtetit e mbështet edhe në ekspertizën e hartuar nga AFK-ja, ku shihet se ky autorizim është përpiluar me dt.08.10.2020. Se dokumenti është i falsifikuar është vërtetuar edhe nga raporti i ekspertimit nga AFK-ja i dt. 19.07.2021, ku ekspertet pranë Agjencionit ne fjale kanë konstatuar se dokumenti “AUTORIZIM” ne baze te programit të përdorur ka rezultuar se është përpiluar me dt. 08.10.2020 e që korrespondon me kohën kur i pandehuri L.B. e ka urdhëruar zyrtari F. B. të përgatisë një dokument të tillë, pra në kohën kur i pandehuri e ka kuptuar se është duke u hetuar nga organet e hetuesisë. Prokurorja e shtetit tutje ka deklaruar se kemi të bëjmë me dokument të falsifikuar është vërtetuar edhe nga vet pranimi i të pandehurit L. i cili në deklarinimin e tij të dhënë në prokurori ka pranuar se ka kërkuar nga zyrtari F. të përpiloj një dokument të tille e që këtë veprim i pandehuri nuk e konsideron si veprim të kundërligjshëm veçse gabim të madh i cili ka vepruar në këtë mënyrë për herë të parë e që sipas tij ka menduar që këto veprime e kanë fuqizuar dëshminë e tij. Prokurorja e shtetit tutje ka theksuar se i pandehuri I.H. ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 2 lidhur me par. 1 lidhur me nenin 77 par. 1 pika 1.3 të KPRK-së, është vërtetuar nga provat materiale si: aktvendimi me nr. të protokollit 996/2017 i datës 24.10.2017 me të cilin aktvendim është aprovuar kërkesa zyrtare që ka të bëjë me parcelim prone dhe regjistrim në RDPP-së sipas regjistrimit të terrenit 3/2017, për njësinë kadastrale nr. 28/93, 28/93, 28/94 dhe 28/95 ZK-C. i njëjti aktvendim nuk barte nënshkrimin e drejtorit I. H. por është nënshkruar nga i pandehuri I.H.si udhëheqës i Sektorit për urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë KK- Istog, aktvendimi nr. protokollit 13665/2018 i datës 23.03.2018 sikurse aktvendimi paraprak me të cilin është bërë parcelimi i pronës njësia kadastrale 28/96, 28/97 dhe 28/95 ZK- C.. aktvendimi nr. protokollit 867/2017 i datës 05.10.2017, sikurse aktvendimi paraprak me të cilin është bërë parcelimi i pronës njësia kadastrale 74/5, 74/6, 4/8, 256/2 dhe 256/3 ZK- V. K- I. Nga këto aktvendime është vërtetuar se i pandehuri Ismet Hasi, me veprimin e tij ka konsumuar të gjitha elementet e veprës penale keqpërdorim i pozitës zyrtare nga neni 414 te KPRK-së, për shkak se i njëjti ka pranuar vendimin 01 nr. 65/2017dt. 05.05.2017, vendim i nënshkruar nga Kryesuesi H. B. ku nën pikën 5 të këtij vendimi është konstatuar se obligohet Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje te Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë nga komisioni vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes se cekur në pikën 1 të këtij vendimi, pastaj me kërkesën e G. R., drejtuar gjeodetit të licencuar H. K.i për matje në zonën kadastrale C. sipas vendimit 01 nr. 65/2017 dt. 05.05.2017 për njësinë kadastrale 28-1, janë realizuar matjet e gjeodetit ku pas matjes në terren ka sjell të dhënat e pikërisht gjendjen e vjetër ku pronar është PSHSH e mirë e fshatit Njësia Kadastrale 28-1 kultura Mal 3 sipërfaqja 2827063 dhe gjendjen e re ku pronar i gjertanishëm parcela 28-90 e cila është

krijuar pas ndarjes se parcelës 28-91 kultura Mal 3 sipërfaqja 50.000 e krijuar nga sipërfaqja 2777063 kjo ndarje është përfunduar me dt. 12.09.2017 në prezencën e përfaqësuesit të Kompanisë nga gjeodeti i licencuar H.K.. Tutje prokuroja e shtetit ka shtuar se i pandehuri I.H. a kryer veprat penale për të cilat akuzohet këtë e bazon në dëshmitë e të dëmtuarit Besim Zogu njëherë drejtor i Drejtoratit Qendror të Inspeksionit për Pylltari dhe Gjueti Agjensionin Pyjor i Kosovës, pranë Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë. Po ashtu e mbështet edhe në dëshmitë e dëshmitarit I. H., dhe në dëshminë e dëshmitarit H.K. i cili ndër të tjera është deklaruar se “Komuna pikërisht drejtoria për kadastër dhe gjeodezi ka të drejtë të bëjë ndërrimin e klasave të tokës duke filluar nga klasa e 6 e tutje, kurse nga klasa 1 deri 6 ajo bie në kompetencën e Ministrisë”. Tutje prokurorja e shtetit ka deklaruar se fakt që i pandehuri ka kryer në vazhdimësi veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar edhe nga vet deklarimi i të pandehurit ku ndër të tjera ka deklaruar se: “sipas meje duke u bazuar në vendimin e Kryesuesit unë kam konsideruar se kam vepruar drejte, nëse unë nuk ju kisha përmbajte vendimit të Kryesuesit që e ceka me lart edhe të dhënat të cilat mi ka ofruar gjeodeti i licencuar e të cilin së bashku me G. R. i kam pas vazhdimisht në zyre, sigurisht se unë do të kisha humbur edhe vendin e punës sepse edhe 1 vit me ka mbet në pension, por drejtpërdrejtë askush nuk me ka thënë se nëse nuk i zbaton këtë vendim ti do të përjashtohesh nga puna”. Në fund prokuroja e shtetit ka theksuar se marrja e këtyre aktvendimeve për ndarje dhe ndërrim të destinimit të tokës (ndrim i përhershëm të destinimit të tokës bujqësore nga mal i klasit të 3 në tokë tjetër jo pjellore) është në kundërshtim me ligjin dhe është bërë duke keqpërdorur pozitën zyrtar e në veçanti, me rastin e veprimit kësaj soji është dashur që të merren parasysh ligjet “ligjit për token bujqësore 02/L-26, ligjit për pyje të Kosovës me nr. 2003/3, Udhëzimit Administrative nr. 10/2010 për plotësim dhe ndryshimin e udhëzimit 41/2006 për ndërrim e destinimit të tokës bujqësore pasi që këto ligje fare nuk janë marrë për bazë me rastin e veprimit nga ana e të pandehuri (i njëjti edhe vet ka deklaruar se nuk ka konsultuar këto ligje por vetëm ligjin për kadastër dhe i ka besuar gjeodetit të licencuar H.K.). Andaj nga të lartcekurat prokurorja e shtetit mbetet pranë aktakuzës përshkrimi faktik dhe juridik të veprave penale dhe i propozon Trupit gjyqësor që të pandehurit ti shpall fajtor për veprat e kryera ti gjykoj sipas ligjit dhe ti obligoj në pagesën e shpenzimeve të procedurës penale. Po ashtu propozon që me rastin e marrjes së vendimit mbi caktimin e dënimit si rrethanë rënduese gjykata të vlerësoj shkallen e lartë të dashjes, shkallën e dëmit të shkaktuar Ministrisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Prishtinë e në veçanti edhe vet Komunës së I., motivin e kryerjes së veprave penale, ku të njëjtit kanë vepruar me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vëllain e tani të ndjerë Haki Rugova, kurse si rrethanë lehtësuese prokuroria nuk ka gjetur.

-Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuari B. Z., në fjalën përfundimtare ka theksuar se, përmes provave të ofruara gjatë procedurës hetimore si Inspektorat kanë dëshmuar se OE “.....” sh.p.k. nga Inspektorati ka hasur duke u shfrytëzuar pronën publike me kultur mal në menyre ilegale me qëllim të shfrytëzimit të mineraleve pa kontratë për çka Vendimet me Ref DQIPGJ 150/17 date 18.04.2017, Vendimin me Ref DQIPGJ 154/17 datë 18.04.2017 dhe Vendimin me Ref DQIPGJ 171/17 ju ishin ndërprerë aktivitetet ilegale duke kërkuar emërimin e një komisioni nga Komuna e I. së bashku me një anëtar nga DKR-Pejë për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara dhe vlerësimin e kostos së rehabilitimit të sipërfaqeve të shfrytëzuara pa kontrata duke dëmtuar buxhetin e Kosovës, duke dëmtuar konkurrencën duke degraduar ambientin, por që në fakt këto

vendime nuk ishin zbatuar nga Komuna e I. Këto janë fakte që secili zyrtar brenda Komunës dhe çdo qytetar i Komunës se I. e ka pasur të ditur se ngastra ku është duke operuar” sh.p.k. është e vëllait të Kryetarit prandaj edhe në mënyrë të jashtëligjshme i është mundësuar shfrytëzimi i pronës nga viti 2009 pa qenë të pajisur me kontratë, e një fakt të tillë nuk e ka mohuar as i pandehuri L. i cili në deklaratën e tij të dhënë në Prokurori e ka pranuar se z. G.R.ka qenë duke i shfrytëzuar të njëjtat ngastra para e me u nënshkrua kontrata duke thënë se “kjo është e ditur të gjithë e dinë”. I dëmtuari tutje ka deklaruar se pas nxjerrjes se vendimeve për ndalimin e aktiviteteve OE “.....sh.p.k. dhe disa Operatorëve tjerë dhe vendimit që ia ka dërguar Komunës së Istogut për emërimin e komisioneve për regjistrimin e dëmeve të shkaktuara nga shfrytëzimi ilegal, zyrtarisht me shkresë z. B. M. , Drejtor i Drejtorisë ne Komunën e I. me datë 26.04.2017 e ka njoftuar të dëmtuarin se lidhur me këtë kërkesë Drejtorit të Inspektorarit të datës 24.04.2017 për informim rreth gurëthyesve të cilëve operojnë ne Komunën e I. 1.”.....i” sh.p.k. me seli ne I. Operon në zonën Kadastrale L., Prone shoqërore e mire e shtetit ne ngastrat me nr. 77-79, 77-72, 77-77 dhe 77-76, të “...” sh.p.k.me seli ne V.... operon ne zonën Kadastrale V. prone shoqërore e mire e fshatit me nr. te ngastrave 74-4, 74-3, 256-0., “...” sh.p.k. me seli ne V. operon në Zonën Kadastrale V. pronë e mirë e fshatit me nr. të ngastrës 74-4, “Macon”, sh.p.k. me seli ne C. , operon ne Zonën Kadastrale C., pronë shoqërore e mirë e fshatit me nr. të ngastrës 28-1 dhe vazhdon i dëmtuari duke cituar citatin e fundit “këto prona që i shfrytëzojnë këto kompani janë në procedurë për rregullimin e kontratave për shfrytëzimin afat shkurtër në mes Komunës së I. dhe Operatorëve Ekonomik”. I dëmtuari thotë se të gjithë e kanë ditur se kush i shfrytëzon këto ngastra dhe se me shkrim e konfirmojnë se tani do ju përgatiten kontratat pasi qe Inspektorati i Ministrisë MBPZHR-APK-së që e udhëheq i dëmtuari iu kishte ndaluar aktivitetet. I dëmtuari shtron pyetje se cila është logjika e zhvillimit te procedurave te ankandit dhe emërimit te komisioneve nga Komuna për vlerësimin e fituesve te këtij ankandi ku paraprakisht edhe zyrtarisht deklarohen se do t’ju rregullohen kontratat pa u ndalur tek fakti se a kanë pasur të drejte apo jo, ku pala e dëmtuar por edhe prokuroria e shtetit kane ofruar edhe njoftimet e MAPL si Institucion i cili vlerëson ligjshmërinë e vendimeve të Asambleve Komunale se vendimet e lëshuara nga Komuna e I. për shfrytëzimin afatshkurtër të këtyre ngastrave është ne kundërshtim me dispozitat e legjislacionit ne fuqi pra sipas te dëmtuarit edhe pse Komuna e I. ka qene e njoftuar nga MAPL përmes shkresës zyrtare me nr. 020-737/14 te dt. 27.06.2017, ngastra ka qene e shfrytëzuar nga sh.p.k.pronar e se ciles është G.R.e qe është vëllai i Kryetarit tashme te ndjere H. R. qe ka qenë ne dijeni se me pyje dhe toka pyjore menaxhon Agjencioni Pyjor i Kosovës, pra i dëmtuari ka thënë se Agjencioni ka prova se sh.p.k-ja ka keqpërdorur pëlqimin për lejimin e ndërrimit te destinimit duke filluar me punimet pa u pajisur me kontrate nga Agjensioni e qe Komuna e kishte nxjerr vendimin me ref. KE 310/6 date 02.06.2016 dhe i njëjti OE e kishte paditur Agjensionin ne Gjykatë e qe me Aktgjykimin me nr. A.nr.1722/2017 i është refuzuar kërkesa padia me kërkesën e anulimit të Aktvendimit për revokimin e Pëlqimit. Këtë argument i dëmtuari i ka përmendur për te bërë te qarte gjykatës se sh.p.k.-ja “.....n” ka qene ne dijeni se kush menaxhon me pyje dhe toka pyjore publike, por per shkak se Inspektoriati i Ministrisë i kishte ndaluar aktivitetet ilegale, duke i shpallur te paligjshme vendimet e Komunes se I.KPMM i kishte revokuar Licencat e shfrytëzimit dhe te njëjtat nuk mund ti jepte përderisa OE nuk sjell pëlqim nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, për lejimin e ndërrimit te destinimit te përkohshëm për te gjitha rastet kur kultura ishte mal ose toke pyjore pa marre parasysh pronësinë, duke zgjedhur rrugën tjetër te paligjshme te ndërrimit te

kulturës nga mal ne toke tjetër ne mënyrë që te kane mundësinë te pajisen me licenca nga KPMM e qe e kane realizuar , te arrijnë te marrin vlerësimet edhe nga MAPL ne vitin 2018 e cila megjithatë sqaron se Vendimet e Komunës se I. nuk mund te fillojnë te zbatohen pa arritur marrëveshje me Agjensionin Pyjor te Kosovës me te cilët kane konteste pronësore – juridike dhe për arritjen e këtyre synimeve te pandehurit e lartcekur përmes keqpërdorimit te pozitës dhe autorizimeve zyrtare dhe falsifikimit te dokumentacioneve i kane mundësuar OE: “....” sh.p.k që në mënyrë te paligjshme të fitoj te drejtën e kontratës, përderisa OE ne mënyrë ilegale ka qene duke shfrytëzuar pronën nga viti 2009 për çka ka edhe një kallxim penale, ka edhe aktakuze dhe procedura gjyqësore është ne zhvillim e sipër , përderisa OE: “.....” sh.p.k. për te njëjtën veprë penale, degradim të ambientit dhe zhvillim te aktiviteteve pa kontrate me Agjensionin Pyjor te Kosovës veç është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore ne I.. Ka kërkuar nga gjykata që të pandehurit ti shpallë fajtor për veprat penale për te cilat akuzohen dhe te obligoj Komunën e Istogut që dokumentacionet e falsifikuara ti rikthejë ne gjendjen e mëparshme dhe te kompensoj të gjitha dëmet e shkaktuara pasurisë shtetërore (pyjeve) dhe Agjensionit Pyjor te Kosovës si institucion i cili menaxhon dhe administron me pyjet publike.

Mbrojtësja e të pandehurit L.B. av. A.K., në fjalën përfundimtare ka theksuar se, aktakuza është në përplot paqartësi dhe konfuzitet duke i vë në pah vetëm ato gjëra të cilat janë të mundshme të ndodhin mbi bazën e provave shkresore të cilat demantojnë tërësisht aktakuzën, ashtu që kërkon që gjykata të përqendrohet në piken II- të akuzës në dispozitivin e saj citon dispozitivin duke shtuar se në këtë dispozitiv nuk është e cekur ku dhe kur është kryer vepra penale, kur në kohen që pretendon prokuroria z. B. ishte në Prishtinë dhe autorizim i është dërguar zyrtarit policor H. Xh. sa ishte ai duke u intervistuar në Prishtinë dhe vazhdon të citoj dispozitivin e aktakuzës ku prokuroria pretendon se z. B. “ duke vepruar si person zyrtar-ne dokumentin Zyrtar –Autorizim, shënon të dhëna të rreme dhe me vulë zyrtare e vërteton”, dhe vazhdon me citimin e dispozitivit të aktakuzës ku thuhet se “i pandehuri i lartcekur kërkon nga zyrtari ligjor këtu dëshmitari F. B. ta përpiloi Autorizim “Zyrtarisht/2018 të dt. 18.04.2018 dhe atë të njëjtin ta dërgojë të Kryetari për nënshkrim, dhe në bazë këtyre të lartcekurave mbrojtja bën pyetje se kush e ka përpiluar dokumentin, kush e ka nënshkruar dokumentin, kush i shënon të dhënat të rreme dhe me vulë zyrtare e vërteton, mungon përshkrimi faktik i veprës dhe nuk përcakton me saktësi veprimet e zyrtarëve e në veçanti z. Blakaj i cili as fizikisht nuk ka qenë në I. e aq me pak të ndërmerr ndonjë veprim në përpilim të autorizimit nënshkrimit, vulosjes etj, ose të këtëë pasur qasje në kompjuter të ekzaminuar. Mbrojtja ka vazhduar me pretendimet e saja se prokuroria edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ka arritur të argumentoj dhe të vërtetoj ekzistimin e veprës penale dhe përgjegjësisë penale. Tutje mbrojtja ka bërë përshkrimin e kryerjes së veprës penale falsifikim i dokumentit zyrtar dhe mënyrën se si dënohet duke theksuar se nga dëshmia e dëshmitarit F. B.(citon deklarin e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor) vërtetohet se autorizimi nuk është përpiluar nuk është nënshkruar e as vulosur nga z. Blakaj. Po ashtu mbrojtja ka theksuar se as nga raporti i ekspertimit me numër, AKF-2020-0296, numri referues i hetimeve 2020-KE-115, datë 08.07.2021, sipas konstatimit dhe mendimit përfundimtar është vërtetuar se në kompjuterin e ekzaminuar nuk është gjetur ndonjë komunikim, pra sipas mbrojtjes edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor aktakuza nuk gjen mbështetje në asnjë provë të vetme, dhe se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas Kodit dhe sipas

Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Në fund mbrojtja ka shtuar se gjatë gjithë kohës i mbrojturi i saj ka qenë kooperativë dhe në detaje ka treguar ngjarjen duke shtuar se edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se nga përshkrimi i veprimeve të z. B. ne asnjë pjesë të aktakuzës nuk mund të përcaktohet elementi objektiv dhe subjektiv i veprës penale si element esencial që kërkohet për përmbushjen e kushtit ligjor për ekzistimin e veprës penale, duke shtuar se organi i ndjekjes nuk është e liruar nga angazhimi për të gjetur të vërteten, për këtë arsye kërkon që i z. B. të lirohet nga aktakuza e që ky veprim sipas mbrojtjes do të ishte i drejtë dhe i ligjshëm.

I pandehuri L.B., në fjalën përfundimtare ka theksuar se e mbështet fjalën përfundimtare të mbrojtës së tij dhe nuk ka tjetër qa të shtoj.

Mbrojtësi i të pandehurit I.H.av. N. D. në fjalën përfundimtare ka theksuar se, i mbrojturi i tij vetëm se i ka zbatuar vendimet e Kuvendit Komunal të cilat i janë dërguar nga zyra e Kryetarit të Komunës vendimi nr. 01-65/2017 i dt. 05.05.2017 i cili vendim ishte i nënshkruar nga Kryesuesi i asamblesë Komunale H. B. ku në pikën 5 te atij vendimi është konstatuar se obligohet Drejtoria për Urbanizëm Kadaster dhe mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes se Kompanisë nga komisioni vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur si në vendim dhe i pandehuri ka vepruar ne te njëjtën mënyrë edhe me dy kompanitë përfituese dhe SHPK me pronar G. R. dhe F.D.. Tutje mbrojtja ka cituar mbrojtjen e të pandehurit I. i cili përveç të tjerash ka thënë se lidhur me kërkesat për ndërrimin e kulturës për kompanitë e lartcekura ju ka referuar Ligjit mbi Kadaster nr. 2003/25 neni. 9 pika.9.2 a i cili ligj sipas të pandehurit është ligji kryesor dhe bazik me rastin e ndryshimeve në librat kadastral për paluajtshmeri duke shtuar se pretendimet e prokurorit të shtetit se i pandehuri në vazhdimësi ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet sipas mbrojtjes nuk qëndrojnë sepse sipas mbrojtjes prokuroria nuk është siguruar se të njëjtat kompani a e kanë siguruar pëlqimin për lejimin e ndërrimit të kulturës së paluajtshmerive nga Agjencioni Pyjor i Kosovës si institucion kompetentë sipas Ligjit për tokat bujqësore 02/L-26ligjit për pyje të Kosovës nr. 2003/3, Udhëzimit Administrativ nr. 10/2010 si dhe Udhëzimit Administrativ nr. 41/2006 për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore. Mbrojtja nuk e konteston faktin se me rastin e ndërrimit të destinimit të tokës nuk është e siguruar pëlqimi ashtu siç është kërkuar konform dispozitave të lartcekura mirëpo për mbrojtjen kontestuese ishte fakti se i pandehuri a ka qene i obliguar që vet të siguron atë pëlqim. Sipas mbrojtjes të gjitha provat që janë administruar, e mbështesin mbrojtjen e të pandehurit duke e konsideruar rolin e të pandehurit me shume të karakterit teknik-administrativ si zbatues i ligjit, këtë pretendim mbrojtja e bazon në deponimet e dëshmimeve të dëshmitarëve H. B. i cili në pozitën që ka pasur (të cekur me lartë) asambleja ka marr vendim për dhënien me qera paluajtshmerit kompanive ... dhe ShPK e të cilat pasi që janë shpallur fituese përmes gjeodeteve të licencuar kane bërë matjen dhe përcaktimin e kufijve të parcelave si në shkresat e që në këtë rast veprimet e të pandehurit (gjithmonë sipas mbrojtjes) ka qenë të kryej veprime operativo- teknik. Sipas mbrojtjes edhe detyrat e dëshmitarit H. K.dhe I. H.kanë qenë lidhur me ndërrimin dhe destinimin e paluajtshmerisë dhe nënshkrimin e tyre e që sipas mbrojtjes këto nënshkrime kanë qenë detyrë e dëshmitarit I. H. e që sipas deklaramit të dëshmitarit I. H. vërteton se këto i ka nënshkruar i pandehuri por që ka mundur ti nënshkruaj edhe vet i pandehuri pra mbrojtja ka thënë se dëshmia e dëshmitarit Isa autorizimet e të pandehurit I. H.i bën edhe me të parëndësishme se autorizime tekniko administrative e që nëse i besohet dëshmisë se I. H. ato vendime të asamblesë Komunale

ka mundur ti nënshkruaj çdo punëtor në administratë në drejtoratin e kadastrës. Tutje mbrojtja ka theksuar se prokuroria aktakuzën e ka mbështetur vetëm në deponimin e dëshmisë së dëshmitarit B. Z. i është referuar disa inspektimeve që kanë bërë në terren në cilësi të kryeinspektorit lidhur me disa parregullsi që ka evidentuar me rastin e dhënies me qera të paluajtshmerive nga ana e Komunesë së I. dy operacione ekonomikedhe ShPK. Mbrojtja ka thënë se i mbrojturi tij si person zyrtar nuk ka marr asnjë vendim nuk ka bërë asnjë kërkesë, të vetmin veprim sipas mbrojtjes i pandehuri e ka bërë është jetësimi i atyre vendimeve dhe kërkesave të organeve të tjera Komunale i cili nuk ka mundur ti i shmanget jetësimit të tyre. Sipas mbrojtjes i pandehuri ka vepruar duke i respektuar hierarkinë Komunale sepse sikur veprimet e tija të ishin të kundërligjshme eprori i tij do të kishte intervenuar dhe nuk do të kishte lejuar që të bënte çfarëdo shkelje të ligjit. Mbrojtja konsideron se i pandehuri ka qenë në lajthim juridik gjatë jetësimit të këtyre vendimeve të Komunesë sepse nuk ka mundur të dij se a janë ligjërish në rregull apo jo. Në fund mbrojtja ka thënë se pa besueshmëria dhe pamjaftueshmëria e provave përjashtojnë përgjegjësinë penale të të pandehurit I.H. për veprën penale që i vihet në barrë duke kërkuar që të aplikohet neni 3 i KPP-së (in dubio pro reo) që të vendoset në favor të të pandehurit dhe kërkon nga Trupi Gjykoës që me rastin e vlerësimit dhe analizimit të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjykoësor, për të mbrojturin e tij të merr vendim lirues.

I pandehuri, I. H., në fjalën përfundimtare ka theksuar se e mbështet në tërsi fjalën përfundimtare të mbrojtësi të tij dhe nuk ka tjetër çka të shtoj.

Gjendja faktike e vërtetuar nga Gjykata

Gjykata pas administrimit të provave, i ka vlerësuar të njëjtat veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata gjeti se sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda, PP/I.nr.164/20, të dt. 21.02.2022, i pandehuri L.B., akuzohet për veprën penale falsifikim i dokumentit zyrtar, nga neni 427 par.1, të KPRK-së, ndërsa i pandehuri I. akuzohet, për veprën penale të kryer në vazhdimësi, keqpërdorim i pozitës zyrtare, apo autoritetit zyrtar, nga neni 422 par.2, lidhur me par.1, lidhur me nenin 81 par.1, pika 1.3, të KPRK-së.

Vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri L.B., parashihet në nenin 427 par 1 të KPRK-së, Në nenin 427 par 1 të KPRK-së, është parapare: “Personi zyrtar i cili në dokumentin zyrtar, në regjistër ose në shkresën zyrtare shënon të dhëna të rreme ose nuk shënon të dhënat e duhura apo me nënshkrimin e tij ose me vulën zyrtare vërteton dokumentin zyrtar, regjistrin apo shkresën zyrtare e cila përmban të dhëna të rreme ose mundëson përpilimin e dokumentit, regjistrin ose shkresës së tillë me përmbajtje të rreme, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”

Gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit L.B., përmbushen të gjitha elementet e veprës penale, për të cilën akuzohet pasi që i njëjti në cilësi të personit zyrtarë, me dt. 08.10.2020, duke vepruar si person zyrtar, në dokumentin Zyrtar – Autorizim, shënon të dhëna të rreme dhe me vule zyrtare e vërteton atë, në mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi.

Gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, Gjykata e vërtetoi nga provat materiale dhe personale të administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjykata ju fali besimin deklaratës të dëshmitarit F. B. i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se, Në vitin 2018 nuk ka kërkuar askush që dëshmitari F. B. me përpilu autorizim. Në muajin Mars të vitit 2020, polici hetues H. Xh., ka ardh tek dëshmitari në zyrë dhe ka kërkuar dosjen për njësinë kadastrale 28/95 si dhe një dosje për kompaninë, dhe pasi që dëshmitari F. B. i ka kompletuar dosjet e kërkuara nga hetuesia e ka lajmëruar në telefon policin H., që të vijë ti marr dosjet e gatshme, por për shkak të pandemisë në Mars të vitit 2020, polici ka shkuar ta marrë dosjen në muajin Korrik. Gjatë muajit Tetor, të vitit 2020, ka ardhur prapë polici H. dhe e ka pyet se a ke diçka shtesë për të dorëzuar nga ato që ja ka dorëzuar më herët, dëshmitari i ka thënë që jo të gjitha që i ka pas i ka dorëzuar. Të nesërmen, me 07 Tetor të vitit 2020, në orën 08:11 në mëngjes, dëshmitari F. B. është takuar me L.B. në korridorin e Komunës, ku me këtë rast L.B. i ka thënë dëshmitarit F. B. se ja ka dërguar në email një autorizim dhe nëse kërkon duhet me printu, dhe me ia dërguar Kryetarit për nënshkrim, edhe pse L.B. e ka pas emailin zyrtar të dëshmitarit F., L.B. autorizimin ja ka dërguar në emailin privat të dëshmitarit Faton. Autorizimi i dërguar në formatin e Wordit dhe në të ka qenë e shënuar zyrtarisht /2018, e dt. 18.04.2018. Lulzim Blakaj ka kërkuar nga dëshmitari F. B. që në autorizim të shënojë numrat e kontratave si dhe ta printojë dhe ti dërgohet Kryetarit për nënshkrim dhe vulosje.

Dëshmitari, F., ka deklaruar se atë ditë, diku rreth orës 14:00, ka qenë duke u intervistuar L.B. nga policia hetimore në Prishtinë, ku L. e ka thirr rreth orës 14:00 në telefon dhe i ka thënë printoje autorizimin, dhe dëshmitari F. e ka printuar e ka dërgu tek Kryetari për nënshkrim dhe vulosje, por meqë se Kryetarin personalisht nuk e ka takuar autorizimin e printuar, ia ka dhënë shefit të kabinetit të Kryetarit V. L., i cili pastaj e ka kthyer autorizimin tek dëshmitari të nënshkruar dhe të vulosur. Pasi që autorizimi është nënshkruar dhe vulosur nga Kryetari, dëshmitari pasi që e ka pranuar autorizimin e tillë të njëjtin e ka skanuar dhe ia ka dërguar policit H. Xh., sipas kërkesës së L.. Dëshmitarit F. B. ka deklaruar se në atë autorizim ka futur numrat e kontratave, pasi që gjatë takimit në mëngjes me L. i njëjti i ka thënë me i fut numrat e kontratave dhe me e kompletu autorizimin. Dëshmitari ka deklaruar se L. i ka thënë se ekziston një autorizim i tillë, por nuk po mundet ta gjejë për momentin. Dëshmitari ka shtuar se nuk e ka pas idenë që me veprimet e tij po inkriminohet me kryerjen e ndonjë veprë penale. Dëshmitari po ashtu ka deklaruar se në autorizimin që ia kishte dërguar me email L., ai po ashtu i ka dhënë edhe sqarimin që ai duhet të mbetet zyrtarisht 2018, me dt. 18.04.2018. Po ashtu ka shtuar se pasi ka ndodh rasti e ka kuptuar që ky autorizim nuk ka ekzistuar fare në vitin 2018 prandaj edhe i është vendos fjala zyrtarisht. Dëshmitari F. B. po ashtu ka deklaruar se e mban mend që e ka thirr polici H., L. në telefon, dhe kur e ka pyet për autorizim, e din që përgjigja e L. ka qenë që nuk është në dijeni për atë autorizim, me atë është marr F., sqarohuni me të. Dëshmitari F. aty e ka kuptuar që të gjitha veprimet e L. janë bërë me një planifikim paraprak të mirë organizuar, sepse e ka pas mundësinë atë autorizim ta printojë vet, por nuk e ka bërë një gjë të tillë por ja ka dërguar dëshmitarit F. B..

Faktin se i pandehuri L. ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet vërtetohet edhe nga provat materiale siç janë, Autorizimi, Zyrtarisht /2018 i dt. 18.04.2018, i cili është vulosur dhe nënshkruar nga Kryetari i Komunës Haki Rugova, në të cilin Autorizim është shënuar “Me të cilin Autorizoj z. L.B., nënkryetar i Komunës që në emër timin të nënshkruaj Kontratat për

dhënien në shfrytëzim afatshkurtër me kompaninë OE “.....” SHPK, me seli në I. dhe Kompaninë “.....” SHPK, me seli në V. Komuna I.” e në të cilin autorizim janë shënuar edhe numrat e kontratave dhe vendimeve të Kuvendit Komunal.

Autorizim shabllon i dërguar nga L.B. tek zyrtari ligjor F. B. përmes emalit. Emali i pranuar nga F. B. prej ish nën Kryetarit L.B. e në të cilën është shënuar Autorizim “Me të cilin Autorizoj z L.B., nënkryetar i Komunës, që ne emër timin të nënshkruaj Kontratat për dhënien në shfrytëzim të përkohshëm afatshkurtër me Kompaninë “.....” shpk, me seli në I. dhe Kompaninë “....” Shpk, me seli në V. Komuna I.”.

Nga dëshmia e dëshmitarit F. B., gjykata vërtetoi faktin se, sipas sugjerimeve të të pandehurit L.B., dëshmitari F. këtij autorizimi ja ka shtuar të dhënat me numrat e kontratave, 1. 401/2018 (vendimi i Kuvendit të Komunës nr. 28/2018 i datës 29.03.2018). 2. 402/2018 (vendimi i Kuvendit të Komunës nr. 31/2018 i datës 29.03.2018). 3. 403/2018 (vendimi i Kuvendit të Komunës nr. 29/2018 i datës 29.03.2018). 4. 404/2018 (vendimi i Kuvendit të Komunës nr. 30/2018 i datës 29.03.2018). 1. 405/2018 (vendimi i Kuvendit të Komunës nr. 26/2018 i datës 29.03.2018). 2. 406/2018 (vendimi i Kuvendit të Komunës nr. 25/2018 i datës 29.03.2018). 3. 407/2018 (vendimi i Kuvendit të Komunës nr. 27/2018 i datës 29.03.2018). 4. 408/2018 (vendimi i Kuvendit të Komunës nr. 23/2018 i datës 29.03.2018). Si dhe numrin e autorizimit, Zyrtarisht 2018 i dt.18.04.2018, e të cilin autorizim e ka dërguar tek Kryetari për nënshkrim dhe vulosje dhe pasi që Kryetari i Komunes H. R. e ka nënshkruar dhe vulosur, dëshmitari F. B. i këtë autorizim ja ka dërguar organeve të hetuesisë.

Në Raportin për Ekspertim, punuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzike me nr.AKF-2020-0296 e dt.08.07.2021, është konstatuar: në dëshminë #1 shtëpizë kompjuteri Acer me nr serik:DTX0TEG010655105E579600 me hardisk Toshiba 500GB me nr. serik: Z6BL2D1AS gjatë procesit të kërkimit programet tona kanë identifikuar tre dokumente që brenda tekstit përmbajnë datën e kërkuar sipas urdhëresës 18.04.2018 dhe AUTORIZIM. Këto dokumenta janë të formatit asd dhe janë dokumente të ashtuquajtura “autosaved documents”, të cilat ruhen në, mënyrën automatike nga programi MS WORD. Dy nga këto janë gjetur në dosjen (follderin) users/faton.bujupi/AppData/Roaming/Microsoft/Word, dhe një në shportën ricikluese. Dokumentet më parashtrësën .asd hapën me programin Word duke lëshuar kompjuterin ku gjinden, hapet programi MC Word duke zgjedhur opcionin file dhe pastaj “ Recover unsaved documents” ose duke bartur dokumentin në ndonjë kompjuter të caktuar në dosjen: “shfrytëzuesi” / AppData/Loce/Microsoft/Office/UnsavedFile. Ndërsa sa i përket datës së përpilimit të dokumentit programet tona kanë identifikuar datën e krijimit me datë 08.10.2020. Vlenë të theksohet se sistemi operativ i instaluar në këtë kompjuter është me datë 05.10.2020. Sa i përket komunikimeve ndërmjetë personave të procesuar në urdhëresë, në kompjuterin e ekzaminuar nuk është gjetur ndonjë komunikim dhe nëse bëhet fjalë edhe për komunikimet përmes postës elektronike zyrtare duhet kërkuar ndihma nga ASHI(Agjencia e Shoqërisë së Informacionit). Nga ky raport gjykata vërtetoi faktin se në shtëpizën e kompjuterit me nr. serik Acer me nr serik:DTX0TEG010655105E579600 me hardisk Toshiba 500GB me nr. serik: Z6BL2D1AS të sekuestruar nga i pandehuri L.B. janë gjetur të dhëna të cekura si më lartë e që vërteton faktin se L.B. me dt. 08.10.2020, ka përpiluar Autorizimin të cilin ja ka dërguar

dëshmitarit F., që i njëjti ta plotësojë me të dhëna tjera dhe ta dërgoj tek Kryetari për nënshkrim dhe vulosje.

Gjykata vlerësoi edhe Kontratat për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 401/2018 të dt. 16.07.2017, nr. 402/2018 të dt. 16.07.2017, nr. 403/2018 të dt. 16.07.2017, nr. 404/2018 të dt. 16.07.2017 dhe gjeti se te njëjtat kontrata janë nënshkruar, Për Komunën e I., për Kryetarin H. R., ka nënshkruar L.B., ndërsa për “.....” Shpk ka nënshkruar z.G.R., si dhe Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 408/2018 të dt. 16.07.2017 dhe gjeti se e njëjta kontratë është nënshkruar, Për Komunën e I., për Kryetarin H. R. ka nënshkruar L.B., ndërsa për “.....” Shpk ka nënshkruar z.F. D. E për të cilat kontrata i pandehuri L.B. me dt. 08.10.2020, ka përpiluar Autorizimin, të cilin ja ka dërguar dëshmitarit F., që i njëjti ta plotësojë me të dhëna tjera dhe ta dërgoj tek Kryetari i Komunës së Istogut, për nënshkrim dhe vulosje, për arsye se kinse i pandehuri L.B., ka qenë i autorizuar ti nënshkruaj kontratat e cekur me lartë ne vitin 2018.

Fakti se ne vitin 2018, nuk ka ekzistuar autorizimi për të cilin akuzohet i pandehuri L.B., vërtetohet edhe nga deklarata e dëshmitares Z. S., të dhënë gjatë seancën gjyqësorë, ku e njëjta deklaroi se; në vitin 2018 ka punuar si udhëheqëse e zyrës ligjore ku punon edhe tani. Librin e protokollit të Kryetarit e ka mbajtur dëshmitarja. Me dt. 18.04.2018, nuk kanë protokolu ndonjë autorizim në këtë libërë dhe kopje është edhe protokollit i kësaj date. Pasi që prokurorja ia ofroi në shikim autorizimin zyrtarisht /2018, të dt. 18.04.2018, dhe e pyeti dëshmitaren se “a lëshohet çdo autorizim nga Kryetari në këtë formë” dëshmitarja përgjigjet se, “autorizimi, apo dokumenti në fjalë duhet të përmbajë numrin e protokollit”. Dëshmitarja deklaroi se nuk e ka përpiluar dhe nuk e di se kush e ka përpiluar këtë autorizim ne emër te Kryetarit.

I pandehuri L.B., në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt. 30.04.2021, e ka pohuar faktin se i ka nënshkruar Kontratat për dhënie në shfrytëzim të pronave dhe ka shtuar se është hera e parë që ka nënshkruar për Kryetarin, kur është fjala për dhe, dhe këtë e ka bërë pasi që Kryetari i ka thënë se është në konflikt interes. Po ashtu i pandehuri L.B. ka deklaruar se Autorizim me shkrim nuk ka pas përveç fjalëve që ja ka thënë verbalisht dhe nuk e din se a ka qenë dikush tjetër prezent përveç tij dhe Kryetarit H. R.. Në pyetjen e Prokurorisë se “ a jeni takuar me F. B.?” i pandehuri L.B. është përgjigjur “ se nuk e di a jam takuar kështu personalisht por kemi kontaktuar përmes telefonit dhe unë ia kam dërguar një formë te autorizimit F., dhe nga F. kam kërkuar që ti fut vetëm të dhënat lidhur me kontratat, dhe meqenëse ky autorizim nuk ka pas mundësi te protokollohet i kam thënë F., ta shkruan ne vend te numrit rendorë zyrtarisht / 2018 dhe datën e cekur siç është ne autorizim. Ndërsa në pyetjen se “a tu ka dok i ligjshëm ky veprim nga ana e juaj” i pandehuri është përgjigjur se “nga kënd vështrimi im, jo që është i kundërligjshëm por unë kam gabuar shumë rënd dhe është hera e parë që kam bërë një veprim te tillë, por ne kohen kur unë i kamë ndërmarr këto veprime kam menduar sepse po e fuqizoj dëshminë time”.

Andaj gjykata vlerëson se nga dëshmia e dëshmitarit F. nga vetë deklarata e te pandehurit L.B. e dhënë në Prokurori me dt. 30.04.2021, dhe nga Provat materiale si, Autorizimi, Zyrtarish

/2018 i dt. 18.04.2018, Autorizim shabllon i dërguar nga L.B. tek zyrtari ligjor F. B. përmes emailit, Raporti për Ekspertim, punuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzike me nr.AKF-2020-0296 e dt.08.07.2021, Nga Kontratat për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 401/2018 të dt. 16.07.2017, nr. 402/2018 të dt. 16.07.2017, nr. 403/2018 të dt. 16.07.2017, nr. 404/2018 të dt. 16.07.2017, me nr. 405/2018 të dt. 16.07.2017, dhe nr. 408/2018 të dt. 16.07.2017, gjykata vërtetoi faktin se në veprimet e të pandehurit L.B., qëndrojnë te gjitha elementet e veprës penale “Falsifikim i dokumentit zyrtar” nga neni 427 par. 1 te KPRK-së, po ashtu i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprime e ndërmarra dhe të njëjtat veprime i ka ndërmarrë me dashje, pasi qe i njëjti ne Prokurori ka deklaruar, ne kohen kur i ka ndërmarr këto veprime ka menduar sepse po e fuqizon dëshminë e tij.

Ndaj të pandehurit I.H.

Vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri I. H., “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” e kryer në vazhdimësi, parashihet ne nenin 422 të Kodit Penal te Republikës së Kosovës, kod i cili ka qenë ne fuqi ne kohen e kryerjes së veprës. Ne nenin 422 par 1 të KPRK-së, është parapare: “Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”. Ndërsa në Paragrafin 2, të këtij neni është paraparë se çka përfshin, shpërdorimi i detyrës zyrtare por nuk kufizohet vetëm ne nen paragrafët e cekur te paragrafit 2. Ndërsa ne nenin 81 par 1 te KPRK-së është paraparë “Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim”, ndërsa par.1 pika 1.3 të KPRK-së është paraparë “shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore”

Gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv te këtij aktgjykimi, lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet i pandehuri I. H., Gjykata e vërtetoi nga provat materiale dhe personale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

I pandehuri, I. H., në kohën e kryerjes së veprës penale, ka punuar si Udhëheqës i Sektorit pranë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi ne Komunën e I., me dt. 24.10.2017, duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i ka tejkualuar kompetencat e tij, e me qëllim te përfitimit te dobisë pasurore për operatorin ekonomik “.....”, me pronar G. R., ka marr aktvendim me numër të lëndës /protokollit 996/2017, Zona Katastrale C., me te cilën ka aprovuar kërkesën zyrtare që ka të bëjë me parcelizim te pronës dhe regjistrim ne RDPP-en, sipas regjistrit te terrenit 3/2017 për njësitë kadastrale numër 28/92, 28/93, 28/94 dhe 28/95 ZK C.. Me dt. 23.03.2018, ka marr aktvendim me numër të lendes /protokollit 13665/2018, Zona Katastrale C., me te cilën ka aprovuar kërkesën zyrtare qe ka të bëj me parcelizim e pronës dhe regjistrim ne RDPP-en, sipas regjistrit ne terren 7/2018 qe ka të bëj me parcelim prone për njësinë kadastrale 28/96, 28/97 dhe 28/98 ZK C. dhe Me dt.05.10.2017 duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, i ka tejkualuar kompetencat e tij, e me qëllim te përfitimit te dobisë pasurore për operatorin

ekonomik “...SHPK”, me pronar F. D., ka marr aktvendim me numër të lëndës /protokollit 867/2017, Zona Katastrale V., me te cilën ka aprovuar kërkesën zyrtare që ka të bëjë me parcelim të pronës dhe regjistrim ne RDPP-en sipas regjistrit te terrenit 11/2017, për njësitë katastrale numër 74/5,74/6,74/7,74/8, 256/1,256/2 dhe 256/3 ZK –V..

Fakti se i pandehuri I.H. i ka nënshkruar aktvendimet me numër, të lëndës /protokollit 996/2017 dt.24.10.2017, numër të lëndës /protokollit 13665/2018 dt. 23.03.2018 dhe numër të lëndës /protokollit 867/2017 te dt. 05.10.2017, nuk është mohuar as nga i pandehuri I.H. përkatësisht i pandehuri I.H. në deklaratën e dhënë ne Prokurori me dt. 05.05.2021, ne pyetjen e Prokurores se “ a jeni konsultuar ju me drejtorin e juaj lidhur me 3 vendime që i keni marrë?” i pandehuri I.H. është përgjigjur se “une e kamë njoftuar por që unë kur i kam nxjerrë vendimet ai nuk ka qenë në punë dhe i kam nënshkruar unë”, pra në këtë rast aktvendimet e lartë cekura nuk bartin nënshkrimet e drejtorit I. H., por të njëjtat janë nënshkruar “për” nga I.H., si udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm Kadaster dhe Mbrojtje te Mjedisit pranë Komune së I., andaj nuk ishte kontestues fakti se kush i ka nënshkruar vendimet e cekur me lartë.

Gjykata gjeti se, me datën 20.10.2017 Gjeodeti, H.K., i është drejtuar me kërkesë nr.73/2017, Kërkesë për Drejtoratin Njësine për Urbanizëm dhe Kadaster me të cilën ka theksuar se “me kërkesë të G. R. përfaqësues e Kompanisë “.....” në Istog për parcelim të pronës 2891 sipas kulturës kërkoj që të azhurohet e njëjta në ZK C.” të cilën kërkesë ja ka bashkangjitur certifikatën, manualët nga terreni (gjendja e vjetër dhe gjendja e re) dhe punimi digjital në CD.

I pandehuri I.H.me të pranuar kërkesën e cekur më lartë, ka marrë aktvendim me numër, të lëndës /protokollit 996/2017 dt.24.10.2017, te cilin e ka nënshkruar këtu i pandehuri I. H., i cili në kohen e kryerjes së veprës penale ka qenë Udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm Kadaster dhe Mbrojtje te Mjedisit pranë Komunës së I., mirëpo i njëjti ka nënshkruar “për” drejtorin I. H.me aktvendim është, vendosur “ Aprovohet, kërkesa e zyrtare që ka të bëjë me parcelim prone dhe regjistrim ne RDPP-en sipas regjistrit te terrenit 3/2017 për njësit kadastrale nr. 28/92, 28/93,28/94 dhe 28/95 ZK C..

Me datën 20.03.2018, Gjeodeti H.K. i është drejtuar me kërkesë nr.21/2018 ZK C., Kërkesë për Drejtoratin Njësine për Urbanizëm dhe Kadaster me të cilën ka theksuar se “ pas përpunimit të të dhënave nga terreni dhe elaborati kadastral kërkoj që të njëjtat që të azhurohen në El. Kadastral ZK C., të cilën kërkesë ja ka bashkangjitur certifikatën, manualët nga terreni (gjendja e vjetër dhe gjendja e re) dhe punimi digjital në CD.

I pandehuri I.H.me të pranuar kërkesën e cekur me lartë ka marrë Aktvendim me numër të lëndës /protokollit 13665/2018 te dt. 23.03.2018, te cilin e ka nënshkruar këtu i pandehuri I. H., i cili ne kohen e kryerjes së veprës penale ka qenë Udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm Kadaster dhe Mbrojtje te Mjedisit pranë Komunës së Istogut, mirëpo i njëjti ka nënshkruar “për” drejtorin I. H. me Aktvendim është vendosur “Aprovohet: Kërkesa e zyrtare që ka të bëjë me parcelim prone dhe regjistrim ne RDPP-en sipas regjistrit te terrenit 7/2018 që ka të bëjë me parcelimin prone për njësinë kadastrale 28/96, 28/97 dhe 28/98 ZK C..

Me Kërkesën me nr. të protokollit 867 të datës 14.09.2017 – Kërkesë Për Regjistrimin e Palujtshmërisë, zona kadastrale V., kanë kërkuar nga zyra kadastrale Komunale që në regjistrin e palujtshmërisë të bëjë ndarjen dhe parcelim.

I pandehuri I.H.me të pranuar kërkesën e cekur më lartë ka marrë Aktvendim me numër të lëndës /protokollit 867/2017 dt. 05.10.2017, te cilin e ka nënshkruar këtu i pandehuri I. H., i cili në kohën e kryerje së veprës penale ka qenë Udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë Komunes së I., mirëpo i njëjti ka nënshkruar “për” drejtorin I. H. me Aktvendim është vendosur “Aprovohet, kërkesa Zyrtare që ka të bëjë me parcelim prone dhe regjistrim ne RDPP-en sipas regjistrit te terrenit 11/2017 për njësit Kadastrale nr.74/5, 74/6, 74/7, 74/8, 256/1, 256/2 dhe 256/3 ZK V..

Gjykata gjeti se i pandehuri I. H., përmes këtyre aktvendimeve ka aprovuar kërkesën Zyrtare, mirëpo në fakt nuk ka specifikuar as nga kush kanë arrite këto kërkesa zyrtare, apo çfarë numri mbartin këto kërkesa zyrtare, por ka marr aktvendimin kur ka aprovuar kërkesat për parcelimin e pronave të cekura si në dispozitiv te këtij aktgjykimi dhe ka aprovuar regjistrimin në RDPP-en, sipas regjistrit të terrenit, e ku si pasojë e këtyre vendimeve gjykata vlerëson se është bërë parcelizimi i njërive kadastrale të cekura si më lartë, e po ashtu është bërë ndërrimi i destinimit te tokës bujqësore nga Mal i klasit i 3, në tokë jo pjellore, me këtë rast ka tejkaluar kompetencat e tij zyrtare, pasi qe Komuna e I. nuk e ka pas një kompetencë të tillë për parcelimin dhe ndryshimin e destinimit te tokës bujqësore nga Mal i klasit i 3, në tokë jo pjellore.

Ligji nr. 02/L-26 për tokën bujqësore ne nenin 10, ka paraparë klasifikimin e tokës bujqësore, neni 10.2 ka paraparë “ Çdo ndërrim i destinimit sipas paragrafit 3 te këtij neni, mund te bëhet vetëm sipas ligjit dhe me vendim te organit kompetent Komunal, pasi te jetë marrë pëlqimi nga Ministria ne projektin e rregullit hapësinor.”, Neni 10.5 është paraparë “ në planet hapësinore sipas vlerës se shfrytëzimit dhe boniteti të saj toka bujqësore përcaktohet: a) klasa 1-4 përcaktohet vetëm si tokë bujqësore, përkatësisht si tokë pyjore; b) klasa 5 dhe 6 përcaktohet si tokë bujqësore, pyjore dhe përjashtimisht si tokë për qëllim tjera; c) klasa 7 dhe 8 përcaktohet si tokë bujqësore e cila sipas nevojës shfrytëzohet edhe për qëllim tjera.”

Ligjit nr. 2003/3, Për Pyjet e Kosovës, ne nenin 13 paragraf, a) ka paraparë “Komunat ose organet e tjera me kompetencë për të aprovuar shndërrimin e pyjeve dhe tokave private për shfrytëzim jopyjore do të marrë pëlqimin nga Ministria e cila do të konsultohet me Agjencinë Pyjore para dhënies se një aprovimi te tillë”

Ne nenin 4 par 1 të Ligjit nr. 2003/3, Për Pyjet e Kosovës i plotësuar sipas nenit 2 të Ligjit nr. 03L-153, për Ndryshimin e Plotësimin e Ligjit nr. 2003/3, për pyjet e Kosovës, është paraparë “organi administrativ Komunal qe merret me çështjen e pronësisë mund te vendosë mbi shtrirjen e kufijëve të pyjeve dhe tokave pyjor përbrenda Komunave me pëlqimin e Ministrisë”

Ne nenin 13 par 2, të udhëzimit administrativ nr.41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore është paraparë, “për ndërrimin e destinimit të pyjeve apo tokave pyjore përveç kushteve dhe procedurave të përcaktuara me këtë udhëzim Administrativ, për të gjitha klasat

e tokës duhet te merret pëlqimi nga Ministria e cila para dhënies së pëlqimit konsultohet me Agjencinë Pyjore të Kosovës”

Udhëzimi administrativ Nr.10/2010, për ndryshimin dhe plotësimin të udhëzimit administrativ Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, akt administrativ që derivon nga Ligji për Toka Bujqësore Ligjin Nr.02/L-26. Në nenin 4 të Udhëzimit administrativ Nr.10/2010, për ndryshimin dhe plotësimin të udhëzimit administrativ Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore është përcaktuar “neni 13 pas paragrafit 2 shtohen paragrafë të reja ;3, 4, 5, 6, 7, 8 dhe 9 si vijon: 13.3 për pyjet dhe tokat pyjore shtëtrore dhe private vendimi për ndërrim të destinimit merret nga AKP-ja. 13.4 Kërkesa e kompletuar me dokumentacionin e nevojshëm për ndërrimin e përkohshëm të destinimit dhe marrja me qira të pyjeve i bëhet AKP-së.

Në këtë rast Gjykata vlerëson se Komuna e I., konkretisht i pandehuri, I. H., nuk ka poseduar një Pëlqim nga Ministria, për parcelizimin dhe ndërrimin e destinimit, andaj konform dispozitave ligjore, të cekura më lartë, Komuna e Istogu e në këtë rast i pandehuri I. H., nuk ka pas kompetencë që të aprovoj parcelizimin pronave dhe regjistrimin në RDPP-en, sipas regjistrimit të terrenit, andaj i pandehuri I. H., ka tejkaluar kompetencat e tij, me rastin e marrjes së këtyre aktvendimeve.

Gjykata vlerëson se i pandehuri I.H.me dashje, i ka tejkaluar kompetencat e tij, për qellim të përfitimit të dobisë pasurore për operatorin ekonomik “...”, me pronar G. R. dhe Operatorin ekonomik “.....” me Pronar F. D..

Gjykata gjeti se Kryetari i Komunës së I. H. R., ka bërë propozim, 01 Nr.160/2017 me datën 14.04.2017 për dhënien në shfrytëzim, në pikën 1 sipërfaqja prej 5 hektari nga njësia kadastrale nr.28-1 në zonën kadastrale C. PSHSH e mirë e fshatit të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në pikën 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Pikën I. të këtij vendimi.

Kuvendi Komunal i I. me vendimin 01 nr. 65/2017 e datës 05.05.2017 të nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal të I.H. B., është vendosur në pikën. 1. sipërfaqja prej 5 hektari nga njësia kadastrale nr.28-1 në zonën kadastrale C. PSHSH e mirë e fshatit të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimit të gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në pikën 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Pikën I. të këtij vendimi.

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin me nr. 020-737 të dt.15.06.2017, ka vlerësuar vendimin e Kuvendit Komunal të Istogut 01 nr.65/2017 për dhënien në shfrytëzim

afatshkurtër për 15 vite, sipërfaqen prej 5 hektarë, nga ngastra kadastrale nr.28-1, në zonën kadastrale C., PSHSH e mirë e fshatit dhe ka ardhur në përfundim se “ pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së I., që të ndërmarr veprime konkrete që aktin e Komunës ta harmonizojë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për shqyrtim të aktit..

Kuvendi Komunal në I. me vendimin 01 nr. 68/2017 të datës 05.05.2017 të nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit Komunal të I., H.i B., ka vendosur që sipërfaqja prej 6930 m² nga ngastra kadastrale nr.74/6, sipërfaqe prej 10356 m² njësia kadastrale 256, sipërfaqe prej 80695 m² njësia kadastrale 74-3, në zonën kadastrale V., PSHSH e mirë e fshatit, të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në piken, 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Piken I. të këtij vendimi.

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal, me vendimin me nr. 020-737 të dt.15.06.2017, ka vlerësuar vendimin Komunal të Istogut 01 nr.68/2017 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, sipërfaqen prej 6930 m² nga ngastra kadastrale nr.74/6 (e përmirësuar 74/4), sipërfaqe prej 10356 m² njësia kadastrale 256, sipërfaqe prej 80695 m² njësia kadastrale 74-3, në zonën kadastrale V., PSHSH e mirë e fshatit dhe ka ardhur në përfundim se “ pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka kërkuar nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së I., që të ndërmarr veprime konkrete që aktin e Komunës ta harmonizojë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për shqyrtim të aktit.

Dëshmitari, H. B., gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor deklaroi, Kryesues i Kuvendit Komunal ka qenë nga viti 2014, deri në fund të vitit 2017. Gjatë kohës sa ka qenë Kryesues i Kuvendit, Kuvendi me propozim të Kryetarit ka marr vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të sipërfaqes prej 5 hektarësh nga njësia kadastrale 28/1 në ZK, X. PSHSH e mirë e fshatit. Sa i kujtohet ka qenë në pyetje përfaqësues i të cilës ka qenë I.R. vëllai i Kryetarit H.R.. Nuk e din a ka qenë seanca e njëjtë kur janë marr këta dy vendime, mirëpo e dinë që është marr vendim për dhënien në shfrytëzim të sipërfaqeve të cekura më lartë. Si dhe në prokurori me dt. 20.01.2021, ka deklaruar “përgjigja e MAPL-së, ka qenë që këto vendime në kundërshtim me ligjin dhe duke i dhënë arsyetimin se me cilat ligje nuk ka qenë në përputhje këto vendime, pasi që e kemi përgjigjen nga MAPL, është dashur që prapë ta qesim në kuvend dhe ta rishqyrtojmë dhe ta harmonizojmë vendimin me vërejtjet të cilat janë dhënë. Në këtë periudhë kohore janë mbajtur zgjedhjet dhe edhe pse e kemi kthyer në rishqyrtim vendimin atëherë Kryesues është caktuar Q. B.dhe çka ka ndodh më tutje, pyeteni z. Q.”. Pas vendimit të MAPL nuk e di se çka ka ndodh pastaj.

Deklarata e dëshmitarit Q. B., e dhënë në Prokurorinë Themelore në Pejë me dt. 20.01.2021, është lexuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor me dt. 22.06.2023, pasi që dëshmitari Q. B., nuk ka mundur të jetë prezent në shqyrtimin gjyqësor për arsye shëndetësore. Dëshmitari Q. B., në Prokurori kishte deklaruar, se pas zgjedhjeve lokale të vitit 2017 është përzgjedhur, Kryesues i Kuvendit Komunal në I., ndërsa në pyetjen e Prokurores së Shtetit “pasi që keni marr detyrën e kryesuesit a e keni rishqyrtuar vendimet me 01nr.65/17 të dt.05.05.2017, si dhe vendimin me nr. 68/17 të dt. 05.05.2017 sipas sugjerimeve të MAPL-së” dëshmitari është përgjigjur se “me të marr detyrën e kryesuesit është marrë vendim nga Kuvendi dhe atë pikerishë në mbledhjen e dt. 29.03.2018, ku vendimet me nr.1 br.65/17, 1 nr. 66/17 , 1 nr. 67/17 dhe 1 nr. 68/17 të dt. 05.05.2017 janë anuluar”

Agjencioni Pyjor i Kosovës, Drejtorati Qendror i Inspektoratit të Pylltarisë dhe Gjuetisë, me Ref: DQIPGJ-171/17 i datës 26.04.2017, nxjerr vendim ku e obligon Z. G. R., Drejtor i Kompanisë “.....” me seli në K. I., që menjëherë të ndërpresë të gjitha punimet në shfrytëzimin e gurit dhe mineraleve tjera, duke tërhequr edhe të gjitha mekanizmat nga sipërfaqja pyjore të ngastra kadastrale 28/1, zona kadastrale “ C. ” UL70806057-00158, me fletë poseduese 158/09 në Komunën e I.

Agjencioni Pyjor i Kosovës, me datën 25.05.2017, ka marrë vendim me të cilin ka obliguar Kuvendin Komunal të I. që ti revokojë vendimet e datës 05.05.2017 me referencë 65/2017, 66/2017, 67/2017 dhe 68/2017 të Kuvendit të Komunës së I., për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të paluajtëshmërive në ngastrat pyjore ku deri me tani në mënyrë të pa ligjshme kanë operuar disa operator duke nxjerr inerte-gurë dhe zhavorë si dhe vendosur pajisje përcjellëse për përpunimin e tij.

Agjencioni Pyjor i Kosovës, me dt. 07.09.2017, ka përpiluar Listë Distribuimi në të cilën ka përshkruar gjendjen faktike si më poshtë ku ka konstatuar se Kompania “.....” me pronar I. R., nga fsh. C., K. Istog. I. Komisioni i Drejtoris Kordinuese Rajonale në P. për të bërë plotësimin e raportit me nr. 578 të datës 17.07.2017, komisioni me datën 24.08.2017 ka dalë në teren dhe ka bërë majtën e sipërfaqes të shfrytëzuar të tokës pyjore me (gurë dhe zhavorë) në ngastrën me nr. 28/1 ZK C.... në vendin e quajtur “.....” nga Kompania “....” SH.P.K e cila gjatë kësaj periudhe ka shfrytëzuar sipërfaqen prej 0.95 ha.

Agjencioni Pyjor i Kosovës me Aktvendimin me numër Ref: KE-542/17 të datës 25.09.2017, ka marrë Aktvendimin për revokimin e pëlqimit me numër KE-310/16 të datës 02.06.2016 ku në pikën e parë ka cekur se I. Revokohet pëlqimi me numër KE-1058/09 të datës 16.12.2009 të OE: “.....” SH.P.K. I. për shkak të shkeljeve ligjore duke ushtruar veprimtarinë e shfrytëzimit të sipërfaqes duke nxjerr produkte jo drunore-gurit gëlqeror, si dhe konstatimeve të inspektoratit të evidentuara me procesverbalin, nr. 000968 të datës 17.08.2017 dhe procesverbalin, nr.000969 të datës 28.08.2017, dy herë radhazi ka hequr shiritat e inspektoratit për të vazhduar aktivitetet e shfrytëzimit të pronës publike.

Gjykata Themelore në Prishtinë –Departamenti për çështje Administrative , me dt.08.10.2019, ka marrë Aktgjykim A.nr.1722/2017, me të cilin aktgjykim ka Refuzuar, kërkesëpadinë e paditësit “.....” Shpk, me të cilin ka kërkuar që të anulohet vendimi i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/ Agjencia Pyjore e Kosovës me Seli në Prishtinë me nr. Ref:KE-542/17 i dt. 25.09.2017 si e pabazuar.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me dt. 11.12.2017, ka marrë Aktvendim për pezullimin e Licencës, 1. Ndërmarrja “” SH.P.K me nr. biznesi 70253040 posedon licence të shfrytëzimit me nr.868/ICMM/2009, dhe nuk i ka përmbushë kriteret e licencës të cilat janë: a. Ndërmarrja ka humbur në kriter të licencës sepse nuk ka marrëveshje për të drejtat sipërfaqësore në pajtim me nenin 31 paragrafi 1.7. b. Ndërmarrja “ ” SH.P.K nuk ka arrit që të sjellë në KPMM marrëveshjen nga pronari i tokës për shfrytëzim dhe në afatin e paraparë sipas njoftimit nr. 3887 dt. 11.09.2017. c. Agjencia Pyjore e Kosovës sipas Aktvendimit me nr.8341 ka njoftuar KPMM se ndërmarrjes “ “ SH.P.K. i është revokuar edhe pëlqimi i AKP-së për shfrytëzimin e pronës. Njoftim: Sipas shkresës me nr. 9729 dt. 13.11.2017 Prokuroria Themelore Pejë ka njoftuar KPMM që ndaj ndërmarrjes “ “ SH.P.K. ka filluar procedurë penale lidhur sipas nenit 347 të KPRK. Pezullohet Licenca me nr.868/ICMM/2009 e ndërmarrjes “” SH.P.K. me numër biznesit 70253040, deri në marrjen e vendimit të Gjykatës

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) me dt. 11.12.2017, ka lëshuar njoftim për dështim për përmbushje. Ndërmarrja “” SH.P.K. – me nr. biznesit 80037520 posedon licencë të shfrytëzimit me nr. 1470/KPMM/2015, dhe nuk i ka përmbushë kriteret e licencës të cilat janë: a. Ndërmarrja ka humbur një kriter të licencës sepse nuk ka marrëveshje për të drejtat sipërfaqësor në pajtim me nenin 31 paragrafi 1.7. b. Obligohet ndërmarrja që të sjellë në KPMM marrëveshjen nga pronari i tokës për shfrytëzim dhe nëse nuk e sjellin marrëveshjen në afat prej 30 ditësh atëherë licenca e juaj do të pezullohet. c. Në pajtim me vendimin e bordit të dt.20.04.2017 me nr. portokollit 1554 që nëse bartësi i licencës ose lejes nuk arrin të ruaj kualifikimin e tij sipas nenit 6 dhe nenit 31 të ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale ose nuk i përmbush kërkesat materiale të këtij ligji ose nuk iu përmbahet kushteve të ndonjë licence apo leje atëherë ndërmarrja ka afat prej 30 dite nga data e pranimit të këtij njoftimi për të përmbushë kriteret e cekura ne pikën 1 dhe 2 të dispozitivit. Ndërmarrja në rast të mos përmbushjes në afat të kushteve dhe detyrimeve atëherë KPMM do të marrë masat tjera ligjore konform ligjit për Miniera dhe Minerale

Me Njoftimin e Komisionit i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) te dt. 22.01.2018, është njoftuar, ndërmarrja “.....” brenda 60 ditë të sjellë pëlqimin e pylltarisë apo reduktojë zonën në hapësirat në të cilat nuk kërkohet pëlqimi nga AKP-ja. Nëse bën reduktimin e zonës atëherë duhet bëjë edhe ndryshmin e projekteve ne përputhje me zonën e reduktuar. Deri ne plotësimin e e njërit nga kushtet me lartë Vendimi për pezullimin e licencës së shfrytëzimit me numër 868/ICMM/2009 mbetet në fuqi.

Andaj, duke u ditur se për operimin e mëtejshëm te Operatorëve ekonomik “.....” Shpk dhe “....” Shpk, në atë zonë, për marrjen e Licencës nga Komisioni i Pavarur Për Miniera dhe Minerale, Operatoret Ekonomik, duhet ta sjellin Pëlqimin nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, si organ

kompetent për të dhënë pëlqimin , në zonat kadastrale ku kultura bujqësore është Mal, gjykata vlerëson se i pandehuri I. H., ka nxjerrë aktvendimet e cekura si në dispozitiv te këtij aktgjykimi, ku ka lejuar të bëhet parcelimi dhe regjistrimi ne RDPP-en, sipas regjistrit te terenit për njësitë, Kadastrale te cekura ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, e si rezultat i këtij parcelizimi ka ardhur edhe ndryshimi i destinimit të tokës bujqësore nga kulturë, mal klasit të tretë, në tokë jo pjellore. Gjykata vlerëson se arsye se pse I.H.ka bërë ndryshimin e destinimit, ka qenë shmangia nga domosdoshmëria e marrjes së pëlqimit nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, për shfrytëzimin e atyre pronave ku kultura bujqësor është mal. Ndërsa nga ana tjetër KPMM-ja, ka kërkuar nga Operatorët Ekonomik, “.....” dhe “.....” që të sjellin pëlqimin e nga Ministria Përkatësish nga APK-ja, për shfrytëzimin e atyre pronave. Ndërsa pas këtij ndërrimi ju ka mundësuar që të marr licencë nga KPMM-ja, sepse KPMM-ja, nuk e kërkojnë pëlqimin nga APK-ja, në rast se nuk ekziston kultura pyll apo tokë pyjore.

Pasi që i pandehuri I. H., ka marrë aktvendimet me, numër të lëndës /protokollit 867/2017 dt. 05.10.2017, me numër të lëndës /protokollit 996/2017 dt. 24.10.2017, dhe me numër të lëndës /protokollit 13665/2018 te dt. 23.03.2018, dhe pasi që është bërë azhurimi ne regjistrat kadastral, Kuvendi i Komunës së Istogut me datën 29.03.2018 me vendimin 01 nr.19/2018 e të nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit Q. B., ka vendosur, formimin i komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale.

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin 020-445 të datës 16.04.2018, ka vlerësuar vendimin 01 nr.19/2018 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale, të marrë nga Kuvendi Komunal i I. i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit Q. B. dhe ka gjetur se “ pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale”.

Kuvendi i Komunës së I. me datën 29.03.2018 me vendimin 01 nr.20/2018 e të nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit Q. B., ka vendosur formimin i komisionit për ankesa ndaj dhënies ne shfrytëzim të pronës së paluajtshme Komunale.

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin 020-445 të datës 16.04.2018, ka vlerësuar vendimin 01 nr.20/2018 për formimin e komisionit për ankesa të marrë nga Kuvendi Komunal i I. i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit Q. B.dhe ka gjetur se “ pas shqyrtimit të përmbajtës së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale”.

Kuvendi Komunal në Istog me vendimin 01 nr. 23/2018 të datës 29.03.2018, ka marrë vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të cilën vendim e ka nënshkruar Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Istogut Q. B., është vendosur që sipërfaqja prej 9371 m² nga njësia kadastrale nr.000256-2, në zonën kadastrale V. e evidentuar me numër të çertifikatës 1799/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit V. të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit

vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në piken 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Piken I. të këtij vendimi

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin 020-445 të datës 15.05.2018, ka vlerësuar vendimin 01 nr.23/2018 paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të marrë nga Kuvendi Komunal i I. të datës 29.03.2018 dhe ka gjetur se “ pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi”. Mirëpo Ministria ka theksuar se Komuna e Istogut duhet të respektojë rekomandimin e MMPH-së të datës 11.05.2018 me nr.020-445/25 si dhe të këtë parasysh pretendimet pronësore sipas vendimit të Agjensionit Pyjor të Kosovës të datës 26.05.2017, para fillimit të implementimit të këtij akti.

Kuvendi Komunal në I. me vendimin 01 nr. 24/2018 të datës 29.03.2018 ka marrë vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të cilën vendim e ka nënshkruar Kryesuesi i Kuvendit Komunal të I. Q. B., është vendosur që sipërfaqja prej 19110 m² nga njësi kadastrale nr.00074-10, në zonën kadastrale V. e evidentuar me numër të çertifikatës 247/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit V. të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në piken 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlersues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Piken I. të këtij vendimi

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin 020-445 të datës 15.05.2018, ka vlerësuar vendimin 01 nr.24/2018 paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të marrë nga Kuvendi Komunal i I. me datën 29.03.2018 dhe ka gjetur se “ pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi”. Mirëpo Ministria ka theksuar se Komuna e Istogut duhet të respektoj rekomandimin e MMPH-së të datës 11.05.2018 me nr.020-445/25 si dhe të këtë parasysh pretendimet pronësore sipas vendimit të Agjensionit Pyjor të Kosovës të datës 26.05.2017, para fillimit të implementimit të këtij akti.

Kuvendi Komunal në I. me vendimin 01 nr. 25/2018 të datës 29.03.2018 ka marrë vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të cilën vendim e ka nënshkruar Kryesuesi i Kuvendit Komunal të I. Q. B., është vendosur që sipërfaqja prej 3213 m² nga njësi kadastrale nr.00074-7, në zonën kadastrale V. e evidentuar me numër të çertifikatës 1799/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit V. të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në piken 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlersues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Piken I. të këtij vendimi.

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin 020-445 të datës 15.05.2018, ka vlerësuar vendimin 01 nr.25/2018 paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të marrë nga Kuvendi Komunal i I. me datën 29.03.2018 dhe ka gjetur se “ pas shqyrtimit të përmbajtës së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi ”. Mirëpo Ministria ka theksuar se Komuna e I. duhet të respektojë rekomandimin e MMPH-së të datës 11.05.2018 me nr.020-445/25 si dhe të këtë parasysh pretendimet pronësore sipas vendimit të Agjensionit Pyjor të Kosovës të datës 26.05.2017, para fillimit të implementimit të këtij akti.

Kuvendi Komunal në I. me vendimin 01 nr. 26/2018 të datës 29.03.2018 ka marrë vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të cilën vendim e ka nënshkruar Kryesuesi i Kuvendit Komunal të I. Q. B., është vendosur që sipërfaqja prej 7623 m² nga njësia kadastrale nr.00074-6, në zonën kadastrale V. e evidentuar me numër të çertifikatës 1799/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit V. të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në piken 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Piken I. të këtij vendimi.

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin 020-445 të datës 15.05.2018, ka vlerësuar vendimin 01nr.26/2018 paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të marrë nga Kuvendi Komunal i I. me datën 29.03.2018 dhe ka gjetur se “ pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi ”. Mirëpo Ministria ka theksuar se Komuna e I. duhet të respektojë rekomandimin e MMPH-së të datës 11.05.2018 me nr.020-445/25 si dhe të këtë parasysh pretendimet pronësore sipas vendimit të Agjensionit Pyjor të Kosovës të datës 26.05.2017, para fillimit të implementimit të këtij akti.

Kuvendi Komunal në I. me vendimin 01 nr. 27/2018 të datës 29.03.2018 ka marrë vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të cilën vendim e ka nënshkruar Kryesuesi i Kuvendit Komunal të I. Q. B., është vendosur që sipërfaqja prej 25023 m² nga njësia kadastrale nr.00074-11, në zonën kadastrale V.e evidentuar me numër të çertifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit V. të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në piken 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Piken I. të këtij vendimi.

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin 020-445 të datës 15.05.2018, ka vlerësuar vendimin 01 nr.27/2018 paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të marrë nga Kuvendi Komunal i I.me datën 29.03.2018 dhe ka gjetur se “ pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural

është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi”. Mirëpo Ministria ka theksuar se Komuna e Istogut duhet të respektojë rekomandimin e MMPH-së të datës 11.05.2018 me nr.020-445/25 si dhe të këtë parasysh pretendimet pronësore sipas vendimit të Agjensionit Pyjor të Kosovës të datës 26.05.2017, para fillimit të implementimit të këtij akti.

Kuvendi Komunal në I. me vendimin 01 nr. 28/2018 të datës 29.03.2018 ka marrë vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të cilën vendim e ka nënshkruar Kryesuesi i Kuvendit Komunal të I. Q. B., është vendosur që sipërfaqja prej 5830 m² nga njësia kadastrale nr.00028-92, në zonën kadastrale C. e evidentuar me numër të çertifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C. të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në pikën 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Piken I. të këtij vendimi.

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin 020-445 të datës 15.05.2018, ka vlerësuar vendimin 01 nr.28/2018 paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të marrë nga Kuvendi Komunal i I.me datën 29.03.2018 dhe ka gjetur se “ pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi”. Mirëpo Ministria ka theksuar se Komuna e I. duhet të respektojë rekomandimin e MMPH-së të datës 11.05.2018 me nr.020-445/25 si dhe të këtë parasysh pretendimet pronësore sipas vendimit të Agjensionit Pyjor të Kosovës të datës 26.05.2017, para fillimit të implementimit të këtij akti.

Kuvendi Komunal në Istog me vendimin 01 nr. 29/2018 të datës 29.03.2018 ka marrë vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të cilën vendim e ka nënshkruar Kryesuesi i Kuvendit Komunal të I. Q. B., është vendosur që sipërfaqja prej 8550 m² nga njësia kadastrale nr.00028-94, në zonën kadastrale C. e evidentuar me numër të çertifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C. të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në pikën 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Piken I. të këtij vendimi.

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin 020-445 të datës 15.05.2018, ka vlerësuar vendimin 01 nr.29/2018 paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të marrë nga Kuvendi Komunal i I.me datën 29.03.2018 dhe ka gjetur se “ pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi”. Mirëpo Ministria ka theksuar se Komuna e I. duhet të respektojë rekomandimin e MMPH-së të datës 11.05.2018 me nr.020-445/25 si dhe të këtë parasysh pretendimet pronësore sipas vendimit të Agjensionit Pyjor të Kosovës të datës 26.05.2017, para fillimit të implementimit të këtij akti.

Kuvendi Komunal në I.me vendimin 01 nr. 30/2018 të datës 29.03.2018 ka marrë vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të cilën vendim e ka nënshkruar Kryesuesi i Kuvendit Komunal të I. Q. . është vendosur që sipërfaqja prej 23870 m² nga njësia kadastrale nr.00028-95, në zonën kadastrale C. e evidentuar me numër të certifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C. të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në pikën 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Piken I. të këtij vendimi

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin 020-445 të datës 15.05.2018, ka vlerësuar vendimin 01 nr.30/2018 paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të marrë nga Kuvendi Komunal i I.me datën 29.03.2018 dhe ka gjetur se “ pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi ”. Mirëpo Ministria ka theksuar se Komuna e I. duhet të respektojë rekomandimin e MMPH-së të datës 11.05.2018 me nr.020-445/25 si dhe të këtë parasysh pretendimet pronësore sipas vendimit të Agjensionit Pyjor të Kosovës të datës 26.05.2017, para fillimit të implementimit të këtij akti.

Kuvendi Komunal në I. me vendimin 01 nr. 31/2018 të datës 29.03.2018 ka marrë vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të cilën vendim e ka nënshkruar Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Istogut Q. B., është vendosur që sipërfaqja prej 11750 m² nga njësia kadastrale nr.00028-93, në zonën kadastrale C. e evidentuar me numër të certifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C. të epet në shfrytëzim afatshkurtër për shfrytëzimin e gurit gëlqeror për prodhimin e rërës për ndërtim. Pika 2, afati kohor për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme është 15 vite. Pikat 3,4, specifikohen detyrat komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës. Ndërsa në pikën 5 të këtij aktvendimi –Obligohet Drejtorati për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit që pas përzgjedhjes së Kompanisë, nga Komisioni Vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes së cekur në Piken I. të këtij vendimi.

Ministria Administrimit të Pushtetit Lokal me vendimin 020-445 të datës 15.05.2018, ka vlerësuar vendimin 01 nr.31/2018 paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronës Komunale të marrë nga Kuvendi Komunal i I. me datën 29.03.2018 dhe ka gjetur se “ pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Komunës si më sipër, vlerëson se akti i Komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi ”. Mirëpo Ministria ka theksuar se Komuna e Istogut duhet të respektojë rekomandimin e MMPH-së të datës 11.05.2018 me nr.020-445/25 si dhe të këtë parasysh pretendimet pronësore sipas vendimit të Agjensionit Pyjor të Kosovës të datës 26.05.2017, para fillimit të implementimit të këtij akti.

Komuna e I. me datën 22.05.2018, ka shpallur ankandin publik për shfrytëzimin e pronës së paluajtshme të Komunës, sipas vendimeve 01 nr. 23/2018, 01 nr. 24/2018, 01 nr.25/2018, 01

nr.26/2018, 01 nr.27/2018, 01 nr.28/2018,01 nr.29/2018, 01 nr.30/2018 01 nr.31/2018 të datës 29.03.2018.

Komisioni vlerësues për dhënie në shfrytëzim pronën e paluajtshme me datën 22.06.2018 me vendimin 01 nr. 62/2018, ka shpallur fituesit si në vijim:1. SH.P.K me çmimin më të lartë prej 0.055 euro për m² në vit me njësinë kadastrale, 00028-92, në zonën kadastrale në C., me afat kohor për 15 (pesëmbëdhjetë) vite, të gjitha kushtet plotësohen për marrjen e ankandit. 2.SH.P.K me çmimin më të lartë prej 0.055 euro për m² në vit me njësinë kadastrale, 00028-93, në zonën kadastrale në C., me afat kohor për 15 (pesëmbëdhjetë) vite, të gjitha kushtet plotësohen për marrjen e ankandit. 3. M... SH.P.K me çmimin më të lartë prej 0.055 euro për m² në vit me njësinë kadastrale, 00028-94, në zonën kadastrale në C., me afat kohor për 15 (pesëmbëdhjetë) vite, të gjitha kushtet plotësohen për marrjen e ankandit. 4. SH.P.K me çmimin më të lartë prej 0.055 euro për m² në vit me njësinë kadastrale, 00028-95, në zonën kadastrale në C., me afat kohor për 15 (pesëmbëdhjetë) vite, të gjitha kushtet plotësohen për marrjen e ankandit. 5. SH.P.K me çmimin më të lartë prej 0.052 euro për m² në vit me njësinë kadastrale, 000256/2, në zonën kadastrale në V., me afat kohor për 15 (pesëmbëdhjetë) vite, të gjitha kushtet plotësohen për marrjen e ankandit. 6. SH.P.K me çmimin më të lartë prej 0.053 euro për m² në vit me njësinë kadastrale, 00074-11 në zonën kadastrale në V., me afat kohor për 15 (pesëmbëdhjetë) vite, të gjitha kushtet plotësohen për marrjen e ankandit. 7. SH.P.K me çmimin më të lartë prej 0.054 euro për m² në vit me njësinë kadastrale, 00074-6 në zonën kadastrale në V., me afat kohor për 15 (pesëmbëdhjetë) vite, të gjitha kushtet plotësohen për marrjen e ankandit. 8.I SH.P.K me çmimin më të lartë prej 0.054 euro për m² në vit me njësinë kadastrale, 00074-7 në zonën kadastrale në V., me afat kohor për 15 (pesëmbëdhjetë) vite, të gjitha kushtet plotësohen për marrjen e ankandit. 9. GURI SH.P.K me çmimin më të lartë prej 0.054 euro për m² në vit me njësinë kadastrale, 00074-10 në zonën kadastrale në V., me afat kohor për 15 (pesëmbëdhjetë) vite, të gjitha kushtet plotësohen për marrjen e ankandit.

Gjykata vlerësoi, Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 401/2018 të dt. 16.07.2017, e lidhur ne I., me datën 16.07.2018, ndërmjet Komunës së I., të cilën e përfaqësonte Kryetari, Z. H. R.a si qiradhënës në një rënë anë dhe “” SHPK, me certifikate të regjistrimit, me numër të biznesit 70253040, me numrin fiskal 600068565, të cilën e përfaqësonte, Z. G.R., drejtor nga C., Komuna e I., si qiramarrës. Neni 1 objekt i kontratës. Qiradhënësi, jep në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite pronën e paluajtshme të Komunës me qira, njësinë kadastrale nr. 00028-92, në Zonën Kadastrale në C., në sipërfaqe të përgjithme prej 5830 m², e evidentuar me numër të certifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C., Komuna e I., për qëllim të zhvillimit ekonomik, me qiranë vjetore në shumën totale prej 320.65 (treqind e njëzetë euro e gjashtëdhjetë e pesë centë) ku çmimi për metër katror do të jetë 0,055 euro (cent) për një vit.

Gjykata vlerësoi, Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 402/2018 të dt. 16.07.2017, e lidhur ne I., me datën 16.07.2018, ndërmjet Komunës së I.t, të cilën e përfaqësonte Kryetari, Z. H. R. si qiradhënës në një rënë anë dhe “” SHPK, me certifikate të regjistrimit, me numër të biznesit 70253040, me numrin fiskal 600068565, të cilën e përfaqësonte Z. G. R., drejtor nga C., Komuna e I., si

qiramarrës. Neni 1 objekt i kontratës. Qiradhënësi, jep në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite pronën e palujtshme të Komunës me qira, njësinë kadastrale nr. 00028-93, në Zonën Kadastrale në C., në sipërfaqe të përgjithme prej 11750 m², e evidentuar me numër të certifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C., Komuna e I., për qëllim të zhvillimit ekonomik, me qiranë vjetore në shumën totale prej 646.25 euro (gjashtëqind e katërdhjetë e gjashtë euro e njëzetë e pesë cent) ku çmimi për metër katror do të jetë 0,055 euro (cent) për një vit.

Gjykata vlerësoi, Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 403/2018 të dt. 16.07.2017, e lidhur ne I., me datën 16.07.2018, ndërmjet Komunës së I., të cilën e përfaqësonte Kryetari, Z. H. R. si qiradhënës në njërën anë dhe “” SHPK, me certifikate të regjistrimit, me numër të biznesit 70253040, me numrin fiskal 600068565, të cilën e përfaqësonte Z. G.R., drejtor nga C., Komuna e I. si qiramarrës. Neni 1 objekt i kontratës. Qiradhënësi, jep në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, pronën e palujtshme të Komunës me qira, njësinë kadastrale nr. 00028-94, në Zonën Kadastrale në C., në sipërfaqe të përgjithme prej 8550 m², e evidentuar me numër të certifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C., Komuna e I., për qëllim të zhvillimit ekonomik, me qiranë vjetore në shumën totale prej 470.25 euro (katërqind e shtatëdhjetë euro e njëzetë e pesë cent) ku çmimi për metër katror do të jetë 0,055 euro (cent) për një vit.

Gjykata vlerësoi Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 404/2018 të dt. 16.07.2017, e lidhur ne I., me datën 16.07.2018, ndërmjet Komunës së I., të cilën e përfaqësonte Kryetari, Z. H. R. si qiradhënës në njërën anë dhe “” SHPK, me certifikate të regjistrimit, me numër të biznesit 70253040, me numrin fiskal 600068565, të cilën e përfaqësonte Z. G.R., drejtor nga C., Komuna e I., si qiramarrës. Neni 1 objekt i kontratës. Qiradhënësi, jep në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite pronën e palujtshme të Komunës me qira, njësinë kadastrale nr. 00028-95, në Zonën Kadastrale në C., në sipërfaqe të përgjithme prej 23870 m², e evidentuar me numër të certifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C., Komuna e I., për qëllim të zhvillimit ekonomik, me qiranë vjetore në shumën totale prej 1312.85 (njëmijë e treqind e dymbëdhjetë euro e tetëdhjetë e pesë cent) ku çmimi për metër katror do të jetë 0,055 (cent) për një vit.

Nga këto kontrata vërtetohet fakti se Komuna e I., ja ka dhënë në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, Kompanisë “.....” Shpk, pronën e palujtshme të Komunës, njësit kadastrale, nr.00028-92, nr.00028-93, nr.00028-94, dhe nr.00028-95, në Zonën Kadastrale në C., e të cilat njësi kadastrale gjykata gjeti se, janë formuar si rezultat i vendimit të mare nga i pandehuri I.H. me numër të lëndës /protokollit 996/2017 dt.24.10.2017, me cilin vendim ka lejuar parcelimin e pronës dhe regjistrim ne RDPP-en, sipas regjistrimit te terrenit.

Gjykata vlerësoi, Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr.408/2018 të dt.16.07.2018, ndërmjet Komunës së Istogut, të cilën e përfaqësonte Kryetari Z.H. R., si qiradhënës në njërën anë dhe “” SHPK, me certifikate të regjistrimit, me numër të biznesit 8003750, me numër fiskal 600500898, të cilën e përfaqësonte Z. F. D., drejtor nga V., Komuna e I., si qiramarrës. Neni 1 objekt i kontratës. Qiradhënësi, jep në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite pronën e paluajtshme të Komunës me

qira, njësinë kadastrale nr. 000256-2, në Zonën Kadastrale në V., në sipërfaqe të përgjithshme prej 9371 m², e evidentuar me numër të certifikatës 1799/2018 si Pronë Shoqërore - shfrytëzues e mirë e fshatit, V., Komuna e I., për qëllim të zhvillimit ekonomik, me qiranë vjetore në shumën totale prej 489.92 (katërqind e tetëdhjetë e nëntë euro e nëntëdhjetë e dy (cent) ku çmimi për metër katror do të jetë 0,052 (cent).

Nga kjo kontratë vërtetohet fakti se Komuna e I., ja ka dhënë në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite, Kompanisë “.....” Shpk, pronën e palujtshme të Komunës, njësinë kadastrale nr. 000256-2, në Zonën Kadastrale në V., e cila njësi kadastrale, është formuar si rezultat i vendimit të marë nga i pandehuri I. H., me numër të lëndës /protokollit 867/2017 dt. 05.10.2017, me cilin vendim ka lejuar parcelimin e pronës dhe regjistrim në RDPP-en, sipas regjistrimit të terrenit. Po ashtu gjykata gjeti, se në dispozitivin e tretë të veprës penale, ndaj të pandehurit I. H., qëllimi i të pandehurit, ka qenë krijimi mundësisë së përfitimit për OE “.....” e jo siç është cekur në aktakuzë “.....”, pasi që gjykata vërtetoi faktin se nga vendimi marë nga i pandehuri, I. H., me numër të lëndës /protokollit 867/2017 dt. 05.10.2017, ka përfituar Kompania “.....” përkatësisht kjo Kompani ka përfituar kontratën me nr. 408/2018 dt. 16.08.2018, si dhe Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim pronën e palujtshme me datën 22.06.2018 me vendimin 01 nr. 62/2018, ka shpallur fituesit kompaninë “.....” shpk për njësinë kadastrale, 00074-11, njësinë kadastrale, 00074-6 dhe njësinë kadastrale, 00074-7 në zonën kadastrale në V..

Nga Çertifikata e Pronës për ngastrat kadastrale, nr. 00028-92, me numër të lëndës 2086/2018 të datës 21.03.2018, në Zonën Kadastrale në C., shifet se sipërfaqja prej 5830 m² është krijuar me dt. 23.10.2017 dhe azhuruar, me datën 25.10.2017, pra vetëm një ditë pasi që i pandehuri I. H., kishte marrë aktvendimin, me numër të lëndës /protokollit 996/2017, Zona Katastrale C., e të cilën sipërfaqe pas ankandit publik të shpallur, Komuna e Istogut si qiradhënës, lidhë Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Palujtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 401/2018 të dt.16.07.2018, me kompaninë “.....” shpk, si qiramarrës. Neni 1 objekt i kontratës. Qiradhënësi, jep në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite pronën e palujtshme të Komunës me qira, njësinë kadastrale nr. 00028-92, në Zonën Kadastrale në C., në sipërfaqe të përgjithme prej 5830 m², e evidentuar me numër të certifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C., Komuna e I..

Nga Çertifikata e Pronës për ngastrat kadastrale, nr. 00028-93, me numër të lëndës 2086/2018 e datës 21.03.2018, në Zonën Kadastrale në C., shifet se sipërfaqja prej 11750 m² është krijuar me dt. 23.10.2017 dhe azhuruar, me datën 25.10.2017, pra vetëm një ditë pasi që i pandehuri I.H., kishte marrë aktvendimin, me numër të lëndës /protokollit 996/2017, Zona Katastrale C., e të cilën sipërfaqe pas ankandit publik të shpallur, Komuna e I. si qiradhënës, lidhë Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Palujtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 402/2018 të dt.16.07.2018, me Kompaninë “.....” shpk, si qiramarrës. Neni 1 objekt i kontratës. Qiradhënësi, jep në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite pronën e palujtshme të Komunës me qira, njësinë kadastrale nr. 00028-93, në Zonën Kadastrale në C., në sipërfaqe të përgjithme prej 11750 m², e evidentuar me numër të certifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C., Komuna e I..

Nga Çertifikata e Pronës për ngastrat kadastrale, nr. 00028-94, me numër të lëndës 2086/2018 të datës 21.03.2018, në Zonën Kadastrale në C., shifet se sipërfaqja prej 8550 m² është krijuar me dt. 23.10.2017 dhe azhuruar, me datën 25.10.2017, pra vetëm një ditë pasi që i pandehuri I. H., kishte marrë aktvendimin, me numër të lëndës /protokollit 996/2017, Zona Katastrale C., e të cilën sipërfaqe pas ankandit publik te shpallur, Komuna e I. si qiradhënës, lidhë Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 403/2018 të dt.16.07.2018, me Kompaninë “.....” shpk, si qiramarrës. Neni 1 objekt i kontratës. Qiradhënësi, jep në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite pronën e paluajtshme të Komunës me qira, njësinë kadastrale nr. 00028-94, në Zonën Kadastrale në C., në sipërfaqe të përgjithme prej 8550 m², e evidentuar me numër të certifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C., Komuna e I.

Nga Çertifikata e Pronës për ngastrat kadastrale, nr. 00028-95, me numër të lëndës 2086/2018 të datës 21.03.2018, në Zonën Kadastrale në C., shifet se sipërfaqja prej 23870 m² është krijuar me dt. 23.10.2017 dhe azhuruar, me datën 25.10.2017, pra vetëm një ditë pasi që i pandehuri Ismet Hasi, kishte marrë aktvendimin, me numër të lëndës /protokollit 996/2017, Zona Katastrale C., e të cilën sipërfaqe pas ankandit publik të shpallur, Komuna e I. si qiradhënës, lidhë Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 404/2018 të dt.16.07.2018, me Kompaninë “.....” shpk, si qiramarrës. Neni 1 objekt i kontratës. Qiradhënësi, jep në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite pronën e paluajtshme të Komunës me qira, njësinë kadastrale nr. 00028-95, në Zonën Kadastrale në C., në sipërfaqe të përgjithme prej 23870 m², e evidentuar me numër të certifikatës 2086/2018 si pronë shoqërore shfrytëzues e mirë e fshatit C., Komuna e I.

Nga Çertifikata e Pronës për ngastrat kadastrale, nr. 000256-2, me numër të lëndës 1799/2018 të datës 16.03.2018, në Zonën Kadastrale në V., shifet se sipërfaqja prej 9371 m² është krijuar me dt. 06.10.2017 dhe azhuruar, me datën 09.10.2017, pra vetëm katër ditë pasi që i pandehuri I. H., kishte marrë aktvendimin, me numër të lëndës /protokollit 867/2017, e të cilën sipërfaqe pas ankandit publik te shpallur, Komuna e I. si qiradhënës, lidhë Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 408/2018 të dt.16.07.2018, me Kompaninë “.....” shpk, si qiramarrës. Neni 1 objekt i kontratës. Qiradhënësi, jep në shfrytëzim afatshkurtër për 15 vite pronën e paluajtshme të Komunës me qira, njësinë kadastrale nr. 000256-2, në Zonën Kadastrale në V., në sipërfaqe të përgjithshme prej 9371 m², e evidentuar me numër të certifikatës 1799/2018.

Nga Çertifikata e Pronës për ngastrat kadastrale, 74/5,74/6,74/7,74/8, 256/1,256/2 dhe 256/3 me numër të lëndës 1799/2018 të datës 16.03.2018, në Zonën Kadastrale në V., shifet se këto ngastra kadastrale janë krijuar me datën 06.10.2017, dhe azhuruar me datën 09.10.2017, pra vetëm katër ditë pasi që i pandehuri I. H., kishte marrë aktvendimin, me numër të lëndës /protokollit 867/2017.

Nga Çertifikata e Pronës për ngastrat kadastrale 28/92, 28/93, 28/94 dhe 28/95, me numër të lëndës 2086/2018 të datës 21.03.2018, në Zonën Kadastrale në C., shifet se këto ngastra

kadastrale janë krijuar me dt. 23.10.2017 dhe azhuruar, me datën 25.10.2017, pra vetëm një ditë pasi që i pandehuri I. H., kishte marrë aktvendimin, me numër të lëndës /protokollit 996/2017.

Gjykata pasi vlerësoi provën, HISTORIAT, për njësinë kadastrale 28-95 gjeti se sipas kërkesës së parashtruar nga gjeodeti i licencuar H.K. me nr. 03-940-50767 të datës 20.10.2017, duke u bazuar në vendimin e Kuvendit Komunal në I., 01 nr. 65/2017 e datës 05.05.2017. Sipas evidencës kadastrale njësia kadastrale 28-95, me pronar PSHSH e mirë e fshatit, është krijuar më ndarjen e parcelës 28-91, e cila rezulton me dy kultura, më sipërfaqe 29700 m². Kul. Mal i Kl-3 dhe sipërfaqja 20300 m², Kul. Jopjellore, me sipërfaqe të përgjithshme 50000 m², më çrast janë krijuar 4-parcela të reja dhe ato: 28-92, më sipërfaqe 5830 m², Kul. Mal i Kl-3. 28-93, më sipërfaqe 11750 m², Kul. Jopjellore. 28-94, më sipërfaqe 8550 m², Kul. Jopjellore. 28-95, më sipërfaqe 23870 m². Kul. Mal i Kl-3. Më vonë parcela 28-95, më sipërfaqe 23870 m², Kul. Mal i Kl-3, është ndarë sipas kërkesës nr. 03-941-13815, dt. 20.03.2018, kërkesa e parashtruar nga gjeodeti i licencuar H.K., në 3-parcela të reja: 28-98, me sipërfaqe 475 m², Jopjellore. 28-99, me sipërfaqe 4209 m², Kul. Mal i Kl-3. 28-100, me sipërfaqe 19186 m², Kul. Mal i Kl-3, me pronar PSHSH e mirë e fshatit, ZK.C.. Sipas evidencës kadastrale parcela me nr. 256-2, më sipërfaqe 9371 m², zona kadastrale V., në pronësi të PSHSH e mirë e fshatit V., është krijuar më ndarjen e parcelës 256-0, sipas kërkesës nr. 03-941-44536, të dt. 14.09.2017, më çrast janë krijuar 3-parcela të reja: 256-1, sipërfaqe 5310 m², Kul. Jopjellore. 256-2, sipërfaqe 9371 m², Kul. Jopjellore. 256-3, sipërfaqe 4561 m², Kul.Jopjellore.

Gjykata ja fali besimin deklaratës së Përfaqësuesit të autorizuar të palës se dëmtuar, Agjencisë Pyjore të Kosovës, B. Z., i njëjti është dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku i njëjti deklaroi se, Në vitin 2019, kanë pasur një aksion në nivel vendi me Drejtorinë për hetimin e krimeve të rënda, me KPMM-në, me stacionet policore Komunale, me inspektoriatet e MMPH-së, qëllimi i këtij inspektimi ka qenë identifikimi i degradimit të ambientit, shkatërrimit të shtretërve të lumenjve, gurorët dhe gjatë kontrollës tek këta dy operatorët ekonomik “.....” Shpk dhe “.....” Shpk, gjatë kontrollës kanë verifikuar se aty ka ndryshime të kulturës ku nuk rezulton me kultura pyll, as nuk ekziston ngastra kadastrale 28/1, që ka qenë duke shfrytëzuarSHPK, dhe kanë ngrit dyshimet se këto dokumente janë të falsifikuar për faktin se ishin të njëjtat ngastra, por që tani nuk rezulton kultura pyll te lista poseduese dhe kopjet e planit. Dëshmitari ka shtuar se Dhënia në shfrytëzim e pyjeve dhe tokave pyjore dhe nderimi i destinimit të tyre është kompetencë e APK-së. Me rastin e dhënies së sipërfaqes prej 5 ha, njësia kadastrale 28/1, në ZK C., po ashtu në ZK L. në sipërfaqe prej 56.799 m², nuk janë përfillur këto procedura dhe këtë e kanë vërejtur gjatë inspektimit të vitit 2019, me institucionet tjera si KPMM, MMPH, policisë dhe Drejtorisë së Hetimeve të Krimeve të Rënda, ku u janë prezantuar kontrata e që në fakt nuk figuronte ngastra 28/1, por ishin ndryshuar në ngastra tjera.

Dëshmitari, H.K. i cili është gjeodeti i licencuar, ka theksuar se e ka bërë parcelizimin e parcelës 28/1, e cila evidentohet si pronë shoqërore e mirë e fshatit X., me kërkesë të përfaqësuesit të Kompanisë “.....” G. R.. Ka pasur dy vendime, një vendim-pëlqim i drejtoratit për bujqësi K. Istog, të vitit 2009 dhe vendimin e Kuvendit Komunal në I. të vitit 2017, mirëpo nuk ka qenë në dijeni që për këtë vendim të pronarit i është revokuar licenca dhe pëlqimi për shfrytëzimin e kësaj parcele. Kur kam shku në terren e ka pa se Kompania është në shfrytëzim të kësaj

parcele. Me vendimin e Kuvendit të vitit 2017, i dt. 05.05.2017, në pikën 5 shkruan që pas zgjedhjes së Kompanisë nga komisioni vlerësues të bëjë përkufizimin e sipërfaqes të cekur nën pikën 1, e në pikën 1, shkruan 5 ha, të parcelës 28/1. Parcelizimin e ka bërë, sipas udhëzimit administrativ 02/2013, neni 9. Nëse parcela është mal i pyllëzuar, parcelizimin prapë ka drejtë me e bo gjeodeti për me pëlqimin e autoritetit pyjor, në rastin konkret nuk e ka pas pëlqimin e autoritetit pyjor, për shkak se ditën e matjes aty nuk ka pas pyll, por vetëm gurë çka dëshmohet me orto foto, parcela me nr. 28/1 ka qenë mal i klasës së tretë. Dëshmitari ka shtuar se është e saktë ajo që ka deklaruar në Prokurori se “Komuna pikërisht drejtoria për kadastrë dhe gjeodezi ka të drejtë ndërrimin e klasave të tokës, duke filluar nga klasa 6 e tutje, kurse nga klasa 1 deri 6 bie në kompetencën e Ministrisë”. Me parcelizimin e pronës 28/1, janë nda ngastrat dhe numrat e ngastrave, në parcelën 28/1 me kulturë mal i klasit 3 ka pasur 282 ha, 70 ari dhe 63 m², në parcelizimin është formu parcela 28/90, me kulturën mal të klasit të tretë 277 ha, 70 ari, 63 m² dhe parcela nr. 28/91, mal i klasit të tretë 5 ha. Nga parcela 28/91, janë fituar parcelat nr. 28/92, 28/93, 28/94 dhe 28/95, janë me kultura të ndryshme. Pasi që e kanë bërë këtë ndarje janë regjistruar në zyrën kadastrale. Në vitin 2018, është bërë bashkimi i parcelave 28/92,93,94 dhe 95 me kërkesën e Kompanisë “.....”. Po ashtu dëshmitari është përgjigjur se nuk ka pas njohuri se vendimi i asamblesë Komunale i dt. 05.05.2017, me të cilin ju ka dhënë në shfrytëzim parcela në fjalë Kompanisë është ndryshuar nga MAPL, përkatësisht nuk kam qenë në njohuri për vendimet e Ministrisë. Ndërsa parcelizimin me nr. 28/91, 28/92, 28/93, 28/94 dhe 28/95, e ka bërë në bazë të kërkesës së Kompanisë, në bazë të gjendjes faktike në terren dhe shfrytëzimit aktual.

Gjykata vlerëson se edhe pse gjeodeti, H.K. ka bërë këtë parcelizim, me kërkesë të Përfaqësuesit Kompanisë “.....” duke u bazuar në vendimin e Kuvendit të vitit 2017, i dt. 05.05.2017, i pandehuri I. H., nuk ka qenë kompetent që ta aprovojë këtë parcelim të pronës dhe regjistrim në RDPP-en sipas regjistrimit të terrenit, pasi që kompetent ka qenë Ministria e Bujqësisë së R. Kosovës, në bashkëpunim me APK-në. E duke ja shtuar edhe faktin se, Agjencioni Pyjor i Kosovës, me datën 25.05.2017, ka marrë vendim me të cilin ka obliguar Kuvendin Komunal të I. që ti revokojë vendimet e datës 05.05.2017 me referencë 65/2017, 66/2017, 67/2017 dhe 68/2017, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të paluajtshmërive në ngastrat pyjore.

Gjykata ja fali besimin dëshmisë së dëshmitarit, I. H., i cili, në seancën gjyqësor deklaroi, se nga viti 2010 deri në Korrik të vitit 2018 ka qenë drejtor i urbanizmit, kadastrë dhe mbrojtje të mjedisit në Komunën e I.. Dëshmitari ka deklaruar se ka njohuri gjatë vitit 2017-2018, për vendimet e asamblesë Komunale për prona që janë dhënë në shfrytëzim të përkohshëm kompanive SHPK dhe SHPK në V. dhe X.. Sa e din nuk ka të drejtë askush të bëjë ndërrimin e klaseve vetëm organet më të larta pranë Ministrisë, ndërsa ndërrimin e kulturave e cila dallon mes klasave, kulturën mund ta bëjnë edhe gjeodetët në terren. Dëshmitari pasi e shikoi vendimin me nr. prot. 867/17, të dt. 05.10.2017, të ZK V., deklaroi se nuk është nënshkrimi i tij këtu, mirëpo në bazë të përvojës që ka punuar me Ismet Hasin, është nënshkrimi i I.H.. Dëshmitari deklaroi se nuk e din a ka pas të drejtë I.H.me nënshkru për të. Dëshmitari pasi që e shikoi, aktvendimi me nr. prot 13665/2018, me nr. të lëndës 248/18, dt. 23.03.2018, deklaroi se nuk është nënshkrimi i tij, mundet me qenë i zyrtarit I. H.. Si dhe pasi shikoi, aktvendim me nr. prot 996/2017, ZK-X., dt. 24.10.2017, dëshmitari deklaroi se, nënshkrimi nuk është i tij, por

është i I. Ha.. Dëshmitari I. H. po ashtu ka deklaruar se I.H. nuk i ka dhënë nënshkrimet në prezencën e tij, pasi që nuk e ka pa asnjëherë se ka dhënë nënshkrime për të. Në pyetje të gjykatës se “në kohën kur keni qenë drejtor dhe I.H. është nënshkruar për ju, a e keni ditë në atë kohë se udhëheqësi i sektorit I.H. është duke nënshkruar për ju dhe a i keni dhënë ju ndonjëherë ju autorizim që të nënshkruaj për ju” dëshmitari është përgjigjur “jo nuk e kam ditë dhe nuk i kam dhënë ndonjëherë autorizim për të nënshkruar për mua”.

Nga dëshmia e dëshmitarit I. H., gjykata vërtetoi faktin se dëshmitari I. H., nga viti 2010 deri në Korrik të vitit 2018, ka qenë Drejtor i Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e I., dhe i njëjti ka qenë ne dijeni se për ndërrimin e klasave janë kompetent, vetëm organet më të larta pranë Ministrisë, ndërsa ndërrimin e kulturave e cila dallon mes klasave, kulturën mund ta bëjnë edhe gjeodetët në terren, andaj gjykata vlerëson se për këtë arsye i njëjti edhe nuk i ka nënshkruar këto vendime në cilësi, të Drejtorit për Urbanizmit, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e I., por këto aktvendime i ka nënshkruar, I.H. i cili në ato kohë ka qenë, Udhëheqës i Sektorit pranë Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi ne Komunën e I..

Agjencia Pyjore e Kosovës, Inspektorati Qendror i pyjeve ka përpiluar procesverbalin me datë 18.04.2018 dhe 24.04.2018, ku është bërë inspektimi në operatorin ekonomik “.....”, me lokacion Z.K. 28/1. C., I. Gjatë inspektimit në vend të ngjarjes u konstatua se operatori ekonomik “.....” nuk ka zbatuar vendimin e sipërpërmendura. Pronarit iu është kumtua se Inspektoriati do të vendos prapë shiritat dhe obligoheni që të largohen mjetet deri në momentin e pajisjes me kontratë. Mirëpo gjykata vlerëson se sa i përket faktit nëse kompanitë “.....” shpk me pronar G.i R. dhe I. R., kanë degraduar ose jo, ambientin ne ato zonat kadastrale, Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur Aktakuzën me nr. PP/II.nr.854/2018 me datë, 21.06.2018 për shkak të veprës penale “ Ndotja, Degradimi ose Shkatërrimi i Mjedisit” nga neni 347 par 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e për të cilën aktakuzë akoma nuk është vendosur dhe çështja penale sipas kësaj Aktakuzë është në procedurë në Gjykatën Themelore në Pejë, dega I..

Ndërsa sa i përket Kompanisë “.....” shpk, gjykata gjeti se për këtë rrethanë janë zhvilluar procedura tjera penale, përkatësisht me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë-Dega në Istog P.nr.153/18 i dt. 02.09.2019, ku te pandehurit R. D. dhe F. D. si pronar te Kompanisë “.....i” Sh.p.k, janë shpallur fajtores për shkak te veprave penale “Ndotja degradimi ose shkatërrimi i mjedisit” nga neni 347 par 1 lidhur me nenin 31 te KPRK-së, dhe veprën penale “shkretërimi i pyjeve nga neni 357 par 1 lidhur me nenin 31 te KPRK.

Ndërsa në këtë rast penal sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.164/20, të dt. 21.02.2022, objekt i aktakuzës është vërtetimi i faktit nëse i pandehuri I. H., ka tejkaluar kompetencat e tija zyrtare, me rastin marrjes se aktvendimeve te cekura ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, dhe nëse qëllimi ka qenë përfitimi te dobisë pasurore për operatorin ekonomik, e ku gjykata pas administrimit te gjitha provave si personale ashtu edhe materiale u vërtetua fakti se i pandehuri, I.H. ka tejkaluar kompetencat e tija zyrtare, me rastin e marrjes se aktvendimeve te cekura ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, pasi që Komuna e I.,

përkatësish i pandehuri I. H., nuk ka pas një kompetencë të tillë, por kompetent ka qenë Ministria e Bujqësisë e R. Kosovës, ne bashkëpunim me Agjencionin Pyjor të Kosovës.

Gjykata vlerëson se, motivi për kryerjen e kësaj vepre nga i pandehuri I. H., ka qenë përfitimi material, nga ana e Kompanisë “.....” shpk, dhe “.....” Shpk, duke qenë se, pasi që ishte lejuar parcelizimi i pronës dhe regjistrimi ne RDPP-en, sipas regjistrit te terrenit, ishte bërë ndërrimin e destinimit të përhershëm te pyllit ose tokës pyjore nga Mal i klasit 3, në tokë jo pjellore, me rastin e fitimit te ankandit publik dhe nënshkrimin e Kontratave për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 401/2018, nr. nr. 402/2018, 403/2018 të dt.16.07.2018 nr. 404/2018 dhe 408/2018 të dt.16.07.2018, duke qenë se tani ishte ndërruar destinimi i kulturës bujqësorë, nga kulturë Mal klas 3, në tokë jo pjellore, kompanive “.....” shpk dhe “.....” shpk, ju është mundësuar edhe marrja e licencës nga KPMM-ja.

Gjykata ka administruar edhe provat e propozuara nga mbrojtësi i të pandehurit I. H., si vendimin e Kuvendit Komunal në I., me nr. 01 63/21, i dt. 29.06.2021, vendimin e Kuvendit Komunal në I., nr. 65/21, i dt. 29.06.2021, dhe vendimin e Kuvendit Komunal në I. nr. 66/21, i dt. 29.06.2021, andaj gjykata vlerëson se këto vendime janë marrë nga Kuvendi Komunal në I., për afërsisht 4 vite, nga koha kur i pandehuri I. H., ka marrë vendimet për te cilat tani gjykata e ka shpallë fajtorë, andaj këto vendime të cilat mbrojtësi i të pandehurit I.H. i ka ofruar si prova, nuk vërtetoj ndonjë fakt në favor apo në disfavorë, të të pandehurit I. H., pasi që i përkasin një periudhe të më vonshme diku për afërsisht 4 vite, nga koha e kryerjes së veprës penale. Po ashtu edhe prova e propozuar nga përfaqësuesi i palës së dëmtuar, Raporti i Komisionit Ndërministror i dt.09.07.2020, është marrë për afërsisht 3 vite, nga koha kur i pandehuri I. H., ka marrë vendimet për te cilat tani gjykata e ka shpallë fajtorë, andaj ky Raport, nuk vërteton ndonjë fakt në favor apo në disfavorë, te të pandehurit I. H., pasi që i përket një periudhe të më vonshme diku për afërsisht 3 vite, nga koha e kryerjes së veprës penale nga i pandehuri I. H.. Te gjitha provat e administruara gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor, gjykata i vlerësoj një nga një dhe gjeti se provat tjera, nuk janë relevante për këtë çështje penale, pasi qe nuk kanë te bëjnë me objektin e veprave penale, për te cilat akuzohet këtu i pandehuri, L.B. dhe I. H., dhe nuk vërtetonin asgjë si ne favor ashtu edhe në disfavor të të pandehurve. Dokumentacioni nga Agjencioni Kundër Korrupsionit, kishin te bënin, me tani te ndjerin H. R., ndërsa nuk vërteton ndonjë fakt lidhur me tani të pandehurit L.B. dhe I. H..

Të pandehuri L.B. dhe I. H., gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, kanë shfrytëzuar te drejtën për tu mbrojtur ne heshtje.

Andaj nga te gjitha provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata, vlerësoi se ne veprimet e të pandehurit Ismet Hasi, përmbushen të gjitha elementet e veprës penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” nga neni 422 të KPRK-së, Ne nenin 422 par 1 të KPRK-së, është parapare: “Personi zyrtar, i cili duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i tejkalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat zyrtare të tij me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër apo që t’i shkaktojë dëm personit tjetër ose që seriozisht t’i shkel të drejtat e personit tjetër, dënohet”.

Gjykata gjeti se i pandehuri I. H., në kohen e kryerjes së veprës penale ka qenë person zyrtarë, përkatësish i njëjti ne atë kohë ka qenë në pozitën Udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm Kadaster dhe Mbrojtje te Mjedisit pranë Komune së .

I pandehuri duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin e tij zyrtar ka tejkalaru kompetencat e tij, pasi qe nga provat e administruara u vërtetu, se Komuna e I., përkatësish i pandehuri I.H. nuk ka qenë kompetent për lejimin e parcelimit pronës dhe regjistrim ne RDPP-en, sipas regjistrimit te terrenit, por ka qenë kompetencë e Ministrisë së Bujqësisë të R. Kosovës, ne bashkëpunim me Agjensionin Pyjor të Kosovës.

Qëllimi i përfitimit për personin tjetër, e në këtë raste për Kompanisë “.....” shpk dhe “.....” Shpk, u vërtetu për faktin se, si rezultat vendimeve te cekura ne dispozitiv te këtij aktgjykimi, e të marra nga i pandehuri I. H., ka ardhë deri te parcelimi i atyre pronave, e ku me pas, Kompania “.....” shpk, ka përfituar Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 401/2018, 402/2018, 403/2018 dhe 404/2018 të dt. 16.07.2017, e lidhur ne I., me datën 16.07.2018, ndërmjet Komunës së I., si qiradhënës në njërën anë dhe “.....” shpk, si qiramarrës në anën tjetër, dhe Kompania “.....” ka përfituar Kontratën për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës së Paluajtshme të Komunës Përmes Ankandit Publik me nr. 408/2018 të dt.16.07.2018, e lidhur në I., ndërmjet Komunës së I. si qiradhënës, në njërën anë dhe Kompanisë “.....” shpk në anën tjetër. E ku në këtë rast meqenëse ishte ndërruar kultura bujqësore nga Mal i Klasës 3 ne tokë jo pjellore, atëherë nuk ishte kërkuar pëlqimi nga Ministria dhe APK-ja, për marrjen e licencës nga KPMM-ja, për këta operator ekonomik.

Ndërsa ne nenin 81 par 1 te KPRK-së është paraparë “Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim”, ndërsa par.1 pika 1.3 të KPRK-së, është paraparë “shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore” andaj gjykata vlerëson se i pandehuri në vazhdimësi e ka shfrytëzuar situatën e njëjtë duke qenë Udhëheqës i Sektorit për Urbanizëm Kadaster dhe Mbrojtje te Mjedisit pranë Komune së I., ka marrë aktvendimet e cekura ne dispozitiv te këtij gjykimi.

Sa i përket fajësisë të pandehurit kanë qenë të vetëdijshëm secili veç e veç, për veprën e kryere dhe atë i kanë kryer me dashje. Ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të te pandehurve, kështu qe të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së.

Rrethana lehtësuese për të pandehurin, L.B. gjykata gjeti se, i njëjti me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë vepër tjetër penale dhe ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedure tjetër penale, ndërsa rrethana rëndese ndaj te pandehuri gjykata nuk gjeti.

Ndaj të pandehurit I.H., si rrethana lehtësues gjykata gjeti se, i njëjti me parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë tjetër penale dhe ndaj tij nuk udhëhiqet ndonjë procedure tjetër penale, moshën e tij, pasi që i njëjti tani është pensioner, ndërsa rrethana rëndese gjykata gjeti shkallen e lartë të dashje, pasi që i pandehuri ne vazhdimësi ka kryer këtë veprë penale, dhe motivin e kryerjes së kësaj veprë penal e që ishte përfitimi material për operatorët ekonomik te lartë cekur.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, siç është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit, e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahet nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Te pandehurit L.B., në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne arrest shtëpiak nga dt.09.10.2022 e deri me dt. 20.10.2022.

Konform nenit 59 dhe 62, të KPP-së, të pandehurit L.B., i shqiptohet dënimi plotësues: ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike, ose në shërbimin publik, në kohëzgjatje prej 2 viteve, pas mbajtjes së dënimit me burg.

Ndërsa te pandehurit I. H., gjykata nuk i shqiptoi, dënim plotësues duke qenë se i njëjti tani është pensioner dhe nuk pritet që i njëjti te punoj ne administratën publike apo në shërbimin publik.

Duke u bazuar ne nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPP-se, Gjykata ka përcaktuar për të pandehurit shpenzimet e procedurës penale për secilin veç e veç, në shumën prej 100 (njëqind) euro. Po ashtu të pandehurit secili veç e veç, obligohen të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nënpar.3.2, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të pandehurit i obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke qenë se gjykata nuk kishte prova për te llogaritur shkallën e dëmit të shkaktuar, ndaj Agjensionit Pyjor te Kosovës, si rezultat i vendimeve te marrë nga i pandehuri I. H., gjykata konform nenit 462 par 2, të KPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit i udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, Gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË-Departamenti për Krime të Rënda,
PKR.nr.37/22 me dt. 25.09.2023**

Sekretarja Juridike
Fitore Bojku

Kryetari i trupit gjykues
Shaqë Curri

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.